



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS / AGRICULTURAL UNIVERSITY OF TIRANA

Rr. Pajsi Vodica, Kodër-Kamëz, Tiranë, Albania. / T: +35547200874 / E: info@ubt.edu.al / W: www.ubt.edu.al

ANALIZA PËR MARRËDHËNIET ME **INSTITUCIONET DHE PUBLIKUN** **2024-2025**

Përgatiti:

Prof. Asc. Romina Koto
Prof. Asc. Dritan Laci
Dr. Ina Vejsiu
Klaudia Saraci
Fabjona Prenga
Arba Bushati
Blenard Spaho
Tedi Proda

TIRANË 2025

Përmbajtja:

1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E ANALIZES PËR MARRËDHËNIET INSTITUCIONALE DHE KOMUNIKIMIN 2024-2025	3
Analiza SWOT	Error! Bookmark not defined.
2. VEPRIMTARIA PËR MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET DHE PUBLIKUN.....	6
2.1 Raport për promovimin dhe komunikimin me median UBT. Promovimi i 9 Programeve te reja Bachelor dhe aktivitetet e zhvilluara bazuar në marrëveshjen UBT–BOKU 2030.	6
2.2 Komunikimi me median	8
2.3 Prononcimet e stafit akademik të UBT në media	8
2.4 Aktivitetet promovuese të zhvilluara në UBT	10
2.5 UBGreen	13
2.6 Newsletter	13
2.7 Rekomandime	14
3. ORGANIZIMI I LEKSIONEVE TE HAPURA.	14
3.1 Fakulteti Ekonomisë dhe Agrobiznesit	15
3.2 Fakulteti Mjekësisë Veterinare	16
3.3 Fakulteti Shkencave Pyjore	17
3.4 Fakulteti Bioteknologjisë dhe Ushqimit	20
3.5 Konkluzione	24
4. RAPORTIMI SIPAS FAKULTETEVE. MARRËVESHJE ME INSTITUCIONET, DONATORËT DHE BIZNESET.	24
4.1 Fakulteti Ekonomisë dhe Agrobiznesit	26
4.2 Fakulteti Bioteknologjisë Dhe Ushqimit	29
4.3 Fakulteti Mjekësisë Veterinare	36
4.4 Fakulteti Bujqësisë dhe Mjedisit	38
5. KOMUNIKIMI, AKTIVITETE DHE DALJET NE MEDIA. RAPORTIMI SIPAS FAKULTETEVE.....	42
5.1 Fakulteti Bujqësisë dhe Mjedisit	43
5.2 Fakulteti Ekonomisë dhe Agrobiznesit	47
5.3 Fakulteti Mjekësisë Veterinare	51
5.4 Fakulteti Bioteknologjisë dhe Ushqimit	53
5.5 Fakulteti Shkencave Pyjore	56
5.6 Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve	57
6. AKTIVITETE NE KUADËR TË PROJEKTEVE	58
6.1 Fakulteti Mjekësisë Veterinare	58
6.2 Fakulteti Bujqësisë dhe Mjedisit	60
6.3 Fakulteti Bioteknologjisë dhe Ushqimit	62
6.4 Fakulteti Shkencave Pyjore	65
6.5 Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve	66
7. ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI I RRJETEVE SOCIALE	67
8. PERFORMANCËS SË FAQES ZYRTARE TË UNIVERSITETIT	75
9. PERFORMANCA E QENDRES SE KARRIERES DHE ALUMNI	77
9.1 Gjurmimi i të diplomuarve	81
9.2 Të diplomuarit te FEA dhe punësimi tyre	82
9.3 Të diplomuarit te FBM dhe punësimi tyre	83
9.4 Të diplomuarit te FSHP dhe punësimi tyre	84
9.5 Të diplomuarit te FMV dhe punësimi tyre	84

1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E ANALIZES PËR MARRËDHËNIET INSTITUCIONALE DHE KOMUNIKIMIN 2024-2025

Qëllimi:

Rritja e prezencës institucionale të UBT-së në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar

Qëllimi është forcimi i imazhit publik të UBT-së si një institucion lider në arsimin bujqësor, mjedisor dhe pyjor në Shqipëri, si dhe rritja e njohjes dhe bashkëpunimit me universitete europiane, organizata ndërkombëtare dhe institucionet publike.

Rritja e përfshirjes së studentëve në aktivitetet institucionale dhe akademike

UBT synon të krijojë një komunitet studentor më aktiv, të përfshirë në vendimmarrje, projekte kërkimore, praktika profesionale dhe evente universitare.

Zhvillimi i partneriteteve të qëndrueshme me sektorin privat dhe aktorët e tregut të punës

Qëllimi është të nxisë bashkëpunimin me kompani të cilat operojnë në sektorin agrar, pyjor, ecoturistik dhe organizata të zhvillimit për të rritur mundësitë e punësimit dhe për të modernizuar programet e studimit me qëllim rritjen e efikasitetit të tyre.

Forcimi i komunikimit publik dhe rritja e transparencës institucionale

Objekti është që UBT të komunikojë qartë, në mënyrë profesionale dhe të besueshme të gjitha aktivitetet, arritjet dhe politikat e tij, në përputhje me standardet akademike dhe etikës institucionale.

Objektivat:

Hartimi dhe zbatimi i një strategjie moderne të komunikimit

Përmirësimi i brand-it të UBT-së synon të forcojë identitetin vizual dhe profesional të universitetit, duke e bërë atë më të dallueshëm dhe më të besueshëm në publik. Paralelisht, rritja e prezencës në media dhe rrjete sociale ka për qëllim të shfaqë më gjerësisht arritjet akademike, kërkimore dhe aktivitetet institucionale, duke ndërtuar një komunikim më aktiv me komunitetin. Për të mbështetur këtë qasje, prodhimi i materialeve informuese dhe komunikimeve zyrtare do të realizohet me standarde të larta profesionale, duke siguruar informim të saktë, të rregullt dhe tërheqës për publikun dhe partnerët institucionalë.

Thellimi i bashkëpunimit ndër-institucional kombëtar dhe ndërkombëtar

Të zgjerohet rrjeti i partnerëve strategjikë të UBT me universitete, institucione publike, organizata zhvillimi dhe sektorin privat, në funksion të rritjes së projekteve kërkimore dhe mundësive për studentët dhe stafin.

Rritja e përfshirjes së studentëve në jetën institucionale dhe akademike

Të promovohet pjesëmarrja aktive e studentëve në evente, kërkim shkencor, praktika profesionale dhe procese vendimmarrëse, duke forcuar rolin e tyre si aktorë të rëndësishëm të komunitetit universitar.

Rritja e kapaciteteve të komunikimit profesional dhe kulturës institucionale

Të zhvillohen aftësitë e stafit në komunikim publik, protokoll, diplomaci akademike dhe menaxhim informacioni, duke ndërtuar një kulturë të përbashkët komunikimi, etikë profesionale dhe standard të lartë shërbimi.

ANALIZA SWOT

S –Pikat e Forta

Profil unik akademik në Shqipëri

UBT është institucioni i vetëm i arsimit të lartë me specializim të thelluar në bujqësi, mjedis, pyje, veterinar, agrobiznes dhe bioteknologji, duke pasur rol unik në formimin e profesionistëve të këtyre fushave.

Traditë dhe reputacion shumëvjeçar

Me mbi 70 vite histori, UBT gëzon besueshmëri akademike dhe përvojë të konsoliduar në formimin e specialistëve të sektorit bujqësor dhe mjedisor.

Staf akademik i kualifikuar

Profesorë dhe studiues me përvojë kërkimore, pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare dhe angazhim në publikime shkencore.

Infrastrukturë laboratorike dhe stacione eksperimentale

UBT disponon laboratorë, ferma eksperimentale dhe sera didaktike që ofrojnë mundësi praktike studimi dhe kërkimi të avancuar.

Bashkëpunim me institucione publike dhe ndërkombëtare

Marrëveshje aktive me ministri, bashki, universitete europiane dhe agjenci ndërkombëtare (FAO, UNDP, EU Erasmus+, IPA).

W –Dobësitë

Nevojë për modernizim të plotë të infrastrukturës akademike

Disa ambiente mësimore dhe laboratorike kërkojnë investime të mëtejshme për t'u përshtatur me standardet europiane.

Mungesë e theksuar e digjitalizimit në shërbimet administrative dhe akademike

Proceset e komunikimit, dokumentacionit, raportimit dhe menaxhimit akademik shpesh janë jo të unifikuara dhe jo plotësisht digjitale.

Pjesëmarrje ende e kufizuar e studentëve në kërkim shkencor

Edhe pse kapacitetet laboratorike ekzistojnë, studentët nuk përfshihen mjaftueshëm në projekte të drejtpërdrejta kërkimore.

Promovim i dobët institucional

UBT ka një imazh të fortë në sektor, por komunikimi publik, marketingu akademik dhe prezenca mediatike mund të jenë shumë më të zhvilluara.

Kapacitete të kufizuara financiare

Varësia nga buxheti publik dhe mungesa e burimeve alternative të financimit e kufizon ritmin e zhvillimit dhe inovacionit.

O – Mundësitë

Rritja globale e interesit për bujqësinë e qëndrueshme, agroturizmin dhe sigurinë ushqimore

Këto fusha përputhen drejtpërdrejt me profilin e UBT, duke hapur perspektiva për programe të reja studimi dhe kërkimor.

Integrimi evropian dhe financimet e BE-së

Programet Erasmus+, Horizon Europe, LIFE, IPA III ofrojnë mundësi shumë të mëdha për projekte kërkimore, modernizim dhe shkëmbime akademike.

Rritja e kërkesës për profesionistë në bujqësi, pyje dhe mjedis
Bizneset, institucionet publike dhe shoqatat kërkojnë specialistë të fushës, duke rritur vlerën e diplomave të UBT.

Partneritete me sektorin privat

Bujqësia, agropërpunimi, turizmi rural dhe industria e drurit kërkojnë bashkëpunim me universitetet për inovacion dhe kërkim.

Mundësi zgjerimi në programe të reja modern

Bioteknologjia, klimatologjia, ekonomia e gjelbër, transformimi digjital i bujqësisë (smart agriculture), agro-inxhinieria dhe energjia e rinovueshme janë fusha në rritje që UBT mund t'i integrojë.

T – Kërcënimet

Rënia e interesit të të rinjve për studime universitare

Shumë maturantë zgjedhin programe të tjera ose institucione jopublike, duke ulur numrin e regjistrimeve në disa programe tradicionale.

Emigrimi i të rinjve dhe mungesa e fuqisë punëtore në vend


Kjo ndikon drejtpërdrejt numrin e studentëve të rinj dhe interesin për profesionet bujqësore.

Rënia e numrit total të numrit të maturanëve në nivel Kombëtar.

Të dhënat e INSTAT tregojnë se arsimi i lartë në vend po përballët me një rënie të numrit të studentëve. Për vitin akademik 2024–2025, në auditore janë numëruar 122,613 studentë, nga 123,797 në vitin akademik 2020–2021.

Konkurrenca nga universitetet private apo publike, brenda apo jashtë vendit.

Studentët shqiptarë regjistrohen gjithnjë e më shumë në universitete jashtë vendit, për shkak të programeve të ndërkombëtarizuara dhe bursave.



2. VEPRIMTARIA PËR MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET DHE PUBLIKUN

Veprimtaria për Komunikimin për vitin 2024- 2025

Në analizen e veprimtarisë së komunikimit dhe marrëdhënieve me institucionet të jepet informacion mbi: Realizimin e qëllimeve dhe objektivave të komunikimit dhe promovimit nëpërmjet strumentave Ubgreen, rrjete sociale, takime, dalje në media etj. Raporte të vlerësimit të marrëdhënieve me bizneset, leksione të hapura etj

Ky informacion paraqitet në mënyrë përshkruese dhe tabelare, duke mbajtur në konsideratë minimalisht sa më poshtë:

a. Qëllimet dhe objektivat e komunikimit në Fakultete.

a.1. Realizimi i objektivave për vitin 2025

a.2. Strumentat e komunikimit dhe funksionimi i tyre.

2.1 Raport për promovimin dhe komunikimin me median UBT. Promovimi i 9 Programeve të reja Bachelor dhe aktivitetet e zhvilluara bazuar në marrëveshjen UBT–BOKU 2030.

Gjatë vitit 2025, Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) ka intensifikuar ndjeshëm veprimtarinë e tij promociionale dhe komunikimin institucional me median, me qëllim forcimin e imazhit publik, rritjen e transparencës dhe rritjen e bashkëpunimit me komunitetin akademik, sektorin privat dhe institucionet publike. Përmes komunikimit të vazhdueshëm, UBT ka mundur një prezencë të qëndrueshme në media dhe rrjete sociale duke theksuar arritjet shkencore, aktivitetet studentore dhe rolin e universitetit në zhvillimin e bujqësisë dhe mjedisit në vend.

Objektivat kryesore të komunikimit për 2025 të UBT

Rritja e dukshmërisë së projekteve kërkimore dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare.

Vënia në fokus e aktiviteteve studentore dhe jetës universitare.

Promovimi i programeve studimore dhe mundësive akademike.

Forcimi i marrëdhënieve me median dhe institucione të tjera publike.

Përmirësimi i imazhit të UBT si qendër ekselence në kërkim dhe inovacion.

Promovimi i 9 Programeve të reja dhe aktivitetet e zhvilluara bazuar në marrëveshjen UBT–BOKU 2030.

UBT ka realizuar një fushatë të koordinuar promovimi për marrëveshjen e bashkëpunimit me Universitetin BOKU të Vjenës, e cila synon riorganizimin e ofertës akademike të UBT dhe administrimit, forcimin e shkëmbimeve akademike, projekteve të përbashkëta kërkimore dhe mundësive të mobilitetit studentor.

Në media, marrëveshja është pasqyruar përmes njoftimeve zyrtare apo raportimeve televizive që theksojnë rëndësinë e partneritetit ndërkombëtar të UBT-së me një nga universitetet më prestigjioze evropiane në fushën e shkencave natyrore, ambientit dhe bujqësisë.

Në rrjete sociale, UBT ka realizuar postime dinamike me foto, video dhe citate të ndryshme duke informuar studentët, stafin dhe publikun e gjerë për përfitimet që sjell ky bashkëpunim. Postimet

janë shoqëruar me grafikë promovuese dhe mesazhe motivuese për ndërkombëtarizimin e studimeve.

Në webin zyrtar, janë publikuar artikuj të detajuar me informacion mbi marrëveshjen, qëllimet, fushat e bashkëpunimit dhe mundësitë që hapen për komunitetin akademik të UBT-së. Njoftimet janë pozicionuar në faqen kryesore dhe është i shoqëruar me galeri fotografish dhe linke informative. Kjo fushatë ka synuar rritjen e vizibilitetit të bashkëpunimit strategjik UBT–BOKU dhe informimin e plotë të publikut për rëndësinë dhe impaktin e saj afatgjatë.

Projekti "Strategjia AUT 2030" filloi zyrtarisht më 1 qershor 2024, ky projekt përfaqëson një bashkëpunim transformues ndërmjet Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) dhe Universitetit për Burimet Natyrore dhe Shkencat e Jetës, Vjenë (BOKU), i cili u iniciua me nënshkrimin e një Memorandumi Mirëkuptimi nga qeveritë e Shqipërisë dhe Austrisë në prill 2024. Projekti paraqet një përpjekje strategjike për modernizimin e ofertës akademike të UBT-së, forcimin e kërkimit shkencor dhe përmirësimin e administratës së tij, me qëllim që universiteti të pozicionohet si një qendër rajonale ekselence në fushën e shkencave të jetës.

Që nga nisja e projektit "Strategjia AUT 2030" më 1 qershor 2024, janë zhvilluar gjithsej tetë misione të përbashkëta, nga të cilat gjashtë janë mbajtur në Tiranë dhe dy në Vjenë. Takimet janë shoqëruar me takime dypalëshe, konsultime në terren dhe sesione pune online, duke siguruar një koordinim të vazhdueshëm gjatë gjithë vitit. Katër misionet e para të BOKU-t në Tiranë (qershor, korrik, shtator dhe tetor 2024) janë përqendruar në vlerësimin e gjendjes aktuale të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në UBT. Këto vlerësime kanë përfshirë prezantime nga dekanët e të pesë fakulteteve dhe analiza krahasuese nga ekspertët e BOKU-t. Temat kyçe të diskutuara kanë qenë ngarkesa mësimore, përmbajtja e kurrikulave, regjistrimet e studentëve dhe prioritetet institucionale. Këto shqyrtime ndihmuan në përcaktimin e fushave të kompetencës që projekti AUT2030 do të adresojë përmes reformave të ardhshme

Si output i rëndësishëm janë **9 Programet e reja Bachelor:**

1. **BSc në Shkenca Bujqësore dhe Siguri Ushqimore** – përfshin pesë drejtime specializimi: Agronomi, Hortikulturë, Mbrojtje Bimore, Zootekni dhe Akuakulturë & Peshkim.
2. **BSc në Inxhinieri Mjedisë dhe Ujërash** – i strukturuar me specializime në Menaxhimin e Ujërave dhe Menaxhimin e Burimeve Natyrore.
3. **BSc në Inxhinieri Pyjore** – përfshin drejtime në Menaxhimin e Ekosistemeve Pyjore dhe Ruajtjen e Natyrës & Biodiversitetit.
4. **BSc në Interior Desing dhe Inxhinieri të Industrisë së Drurit** – me specializime në Inxhinieri të Teknologjisë së Drurit dhe Dizajn Mobiljesh & Interior Desing.
5. **BSc në Teknologji Ushqimore** – kombinon sigurinë ushqimore, teknologjitë e përpunimit dhe inovacionin në sistemet ushqimore.
6. **BSc në Shkencë Ushqimore dhe Nutricion** – përgatit studentët për role në kujdesin shëndetësor, edukim ose monitorim të cilësisë ushqimore, duke ofruar bazë shkencore të fortë dhe zbatim praktik.
7. **BSc në Ekonomi** – përfshin profile në Ekonomi të Zhvillimit dhe Ekonomi të Zbatuar.
8. **BSc në Menaxhim Biznesi** – me specializime në Menaxhim Agrobiznesi dhe Turizëm Rural.
9. **BSc në Teknologji Informacioni në Bujqësi dhe Mjedis** – program ndërdisiplinor që kombinon geoinformatikën, analizën e të dhënave, robotikën dhe mjetet digjitale për bujqësi.

2.2 KOMUNIKIMI ME MEDIAN

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025 komunikimet me median u fokusuan në:

Promovimin për hapjen e programeve të reja studimore të riorganizuara sipas Universiteti BOKU të Vjenës. Projekte kërkimore të mbështetura nga partnerë ndërkombëtarë, si GEO-WB6, Helvetas, UNIDO, PHITO, READ, AADF, AMORE-Al etj.

Aktivitetet kryesore studentore dhe eventet institucionale

Konferenca shkencore vendase dhe ndërkombëtare

Nisma për zhvillimin dhe modernizimin e bujqësisë

Gjatë vitit 2025, mediat kanë treguar gatishmëri të plotë për bashkëpunim, duke reflektuar një interes të qëndrueshëm dhe në rritje për temat dhe prezantimet që lidhen me fushat që mbulon UBT. Televizionet kombëtare gjeneraliste kanë qenë veçanërisht të angazhuara në pasqyrimin e aktiviteteve dhe ekspertizës së universitetit, duke kërkuar gjithnjë e më shumë pjesëmarrjen e stafit akademik në programe informuese dhe debate profesionale.

Përfaqësuesit e UBT nga të pesë fakultetet kanë prezantuar institucionin me profesionalizëm dhe përmbytje cilësore, duke kontribuar ndjeshëm në rritjen e vizibilitetit publik të universitetit gjatë gjithë vitit 2025.

UBT është pasqyruar në media me rreth 75 intervistat dhe kronikat televizive të cilat kanë trajtuar tema si: teknologjitë e reja në bujqësi, siguria ushqimore, ndikimi i ndryshimeve klimatike, roli i UBT në zhvillimin rural dhe agronomik, mjedisi, ekonominë agrare etj.

2.3 PRONONCIMET E STAFIT AKADEMIK TË UBT NË MEDIA

Për rrjedhojë për daljet publike të stafit akademik të UBT është krijuar një raport i shkurtër përmbljedhës, me median ku kanë qenë pjesëmarrës dhe tematikën që ka mbuluar:

Në total janë realizuar mbi 75 prononcime për mediat nga përfaqësues të UBT dhe janë refuzuar përafërsisht 7 intervista për tema të ndryshme. Kërkesa e medias për prononcime ka qenë e përafërt me një vit më parë përtë gjitha kanalet e mediatike për tema të ndryshme, ndërsa ka patur më pak intervista të refuzuara krahasuar me një vit më parë.



Figura 1. Intervistat e zhvilluar viti 2024-2025

Rëndësi të madhe kanë marrë edhe daljet mediatike nëpër televizione për promovimin e UBT dhe bashkëpunimin me Universitetin e BOKU në Vjenë, mbi rëndësinë e të studiuarit në degët bujqësore në vend, përfitimet dhe mundësitë e punësimit falë UBT. Ato janë zhvilluar kryesisht nga Rektori i UBT, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku.

Temat ku janë përqëndruar intervistat kanë qenë të ndryshme në varësi edhe të ngjarjeve aktuale të ndodhura në vend dhe disa të tjera të kërkuara nga ne për promovimin e UBT. Më poshtë po paraqesim një tabelë të tematikave të intervistave të grupuara sipas fakulteteve dhe të tjerat me subjekt për promovimin e UBT:




Figura 2. Intervistat sipas Fakulteteve

Profesorët që janë ekspozuar më tepër kanë qenë Rektori Fatbardh Sallaku, Shpend Shahini, Erinda Lika, Kapllan Sulaj, Zef Gjeta, Elvin Toromani, Lumturi Papa, Xhelil Koleci, Kujtim Mersini, Edvin Zhllima, Drini Imami, Erinda Lika, etj.

Mediat që kanë shprehur më tepër interes kanë qenë: Top Channel, A2CNN, Vizion Plus, TV Klan, RTSH, Tv Scan, ABC News , etj.



Figura 3. Numri i Intervistave te stafit dhe Televizionet.

Një tjetër element i rëndësishëm sa i takon mediave është edhe fakti që pjesa më e madhe e tyre përdorin disa kanale për ta promovuar intervistën, pra përveçse e zhvillojnë intervistën live në televizion e hedhin dhe në youtube, dhe në faqen e tyre zyrtare në web, dhe në gazetën print.

Intervistat janë zhvilluar në formën e kronikave në edicione informative, në emisione me shikueshmëri të lartë mëngjesi ose pasditeje etj.

Këto dalje mediatike kanë shërbyer si një kanal i rëndësishëm komunikimi midis UBT-së dhe publikut të gjerë, duke mundësuar shkëmbimin e informacionit shkencor dhe ekspertizës së specializuar në fusha që prekin drejtpërdrejt jetën sociale dhe ekonomike të vendit. Media ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme komente dhe sqarime nga akademikët e UBT-së, duke reflektuar besimin dhe autoritetin profesional që institucioni ka ndërtuar vit pas viti.

Kjo qasje e UBT për të qenë prezent në media do të ndihmojë në zgjerimin akoma më tej të bashkëpunimit, duke u shndërruar në aleatët më të mirë të dhënies së informacionit në unikalitetin që disponon. Rrjedhimisht do të sillte edhe promovimin e kapacitetit tonë akademik, kërkimor dhe ekspertizës tek palët e treta. Zgjerimi i vizibilitetit do të ndihmojë edhe në përcjelljen e mesazheve që UBT synon tek llojet e ndryshme të audiencave përmes kanaleve të ndryshme.

2.4 AKTIVITETET PROMOVUESE TË ZHVILLUARA NË UBT

Aktivitetet e zhvilluara përgjatë këtij viti në Universitetin bujqësor të Tiranës kanë qenë të shumta, duke renditur rreth 283 aktivitete, të cilët janë ndjekur dhe nga Zyra e Komunikimit, dhe janë pasqyruar edhe në rrjetet sociale, ëeb, facebook, instagram, linkedin.

Më poshtë po i pasqyrojmë edhe me grafik dhe tabelë të gjithë aktivitetet e zhvilluara në bazë të grupeve të bëra për tematikën që mbulojnë:




Figura 4. Numri i postimeve sipas aktiviteteve per vitin 2025.

Lloi i aktivitetit	Numri i postimeve 2025
Intervista, shkrime për media	Mbi 75
Panaire	9
Leksione të hapura	20

Erasmus	15
Takime me zyrtarë të lartë	4
Takime ndërkombëtare	11
Promovim i UBT, programeve të studimit	28
Promovim i studentëve	24
Marrëveshje bashkëpunimi me universitete/biznese	11
Sesione informuese	5
Njoftime	13
Mision social	12
Konferenca	24
Workshop	9
Share	8
Aktivitete promovuese BOKU-UBT	52
Promovim projektesh	58

Promovimi i UBT ka të bëjë me promovimin e UBT brenda dhe jashtë Shqipërisë nëpër postime në rrjetet sociale për laboratorët, projektet e realizuara, bankën gjenetike, degët prioritare dhe bursat e studimit, arsyet pse duhet të regjistroheni në programet e studimit në UBT, marrëveshja me Universitetin BOKU të Vjenës etj.

Vend të rëndësishëm ka zënë këtë vit edhe promovimi i studentëve përmes punimeve të tyre apo dhe angazhimeve të ndryshme në orët praktike. Ndryshe nga vitet e kaluara strategjia e ndjekur nga Sektori i Marrëdhënieve me Publikun është fokusuar në përfshirjen dhe promovimin e studentëve, duke i dhënë përparësi kontributit të tyre dhe duke nxitur të jenë ata protagonistët kryesorë.

Konferenca- përfshin konferencat shkencore kombëtare apo ndërkombëtare si Konferenca ICOALS 5 apo Konferenca Kombëtare e Prodhuesve të Pemëve Frutore.

Panairë- përfshihen panairë të ndryshme ku ka marrë pjesë UBT, si Work & Study, Panairi Ndërkombëtar “Ditët e Bujqësisë 2025”.

Leksione të hapura- përfshihen leksione të hapura për tema të ndryshme me përfshirje të të 5 fakulteteve, lektorët kanë qenë të huaj kryesisht (17) dhe (3) shqiptarë. 15 prej leksioneve të hapura janë zhvilluar në kuadër të projekteve me të cilat UBT ka patur bashkëpunim.

Marrëveshje Bashkëpunimi- përfshinë marrëveshjet me persona, institucione, organizata, universitete, përfaqësues biznesesh për tu dakortësuar në një bashkëpunim të ndërsjelltë me përfitim të dyanshëm në kuadër të një çështje, tematike apo kauze të caktuar. Përmendim marrëveshjet me: Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor; Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Cannabis; Shkolla e Mesme Profesionale "Mihal Shahini"; Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit; Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor; Instituti Agronomik Mesdhetar i Zaragozës IAMZ-CIHEAM; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë; Hochschule Geisenheim University; Universiteti i Mjekësisë Tiranë.

Erasmus- Shkëmbime studentësh dhe pedagogësh brenda dhe jashtë për projekte të ndryshme, lëvizjet zhvillohen në vende të ndryshme në rajon, Europë, SHBA, Kanada etj. Për vitin 2025 janë realizuar 15 aktivitete promovuese bazuar në këtë projekt.

Sesione informuese-përfshin takime të ndryshme me persona, organizata, biznese, institucione apo projekte të ndryshme për informimin e studentëve dhe stafit akademik për shërbimin që ofrojnë dhe mundësitë e përfitimit në kuadrin akademik e profesional, që për këtë vit renditen vetëm 5 të tilla.

Takime ndërkombëtare në UBT- përfshin takim e nga zyrtarë të huaj apo përfaqësues universitetesh.

Shpërndarje- Përfshihet postime për tematika të ndryshme nga zyrtarë të lartë shqiptare në aktivitete ku UBT ka qenë pjesëmarrës, Kryesisht pjesa më e madhe e materialeve që janë shpërndarë këtë vit janë gjeneruar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Kryeministri, Organizata apo agjenci të tjera shtetërore.

Aktivitetet promovuese në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes UBT dhe Universitetit BOKU të Vjenës, 52 nga gjithë totali, kanë patur një hapësirë të konsiderueshme përgjatë vitit qoftë me materiale për web, newsletter, ilustrime grafike dhe foto në rrjete sociale. Për të parë ecurinë e aktiviteteve të zhvilluara në këto 4 vitet e fundit po demostrojmë më konkretisht grafikun bashkëngjitur:





Figura 5. Aktivitet e zhvilluara ne UBT viti 2024-2025.

Nisur nga të dhënat e grumbuluara për numrin total të aktiviteteve të promovuar nga UBT dhe të ndjekura nga Zyra e Komunikimit rezulton se krahasuar me një vit më par është ruajtur një numër konstant postimesh.

Bazuar në numrin total të aktiviteteve të zhvilluara në UBT, 58 prej tyre janë në kuadër të projekteve në formën e leksioneve të hapura, sesioneve informuese, konferencave apo eventeve të



ndryshme. Krahësuar me një vit më parë numri i aktiviteteve të realizuara në kuadër të projekteve ka ardhur duke u rritur, kjo tregon edhe larmishmërinë e zgjerimit të bashkëpunimeve që UBT realizon me subjekte të huaja, ku më poshtë rendisim edhe në një grafik:

Sa i takon aktiviteteve në kuadër të projekteve ndër më kryesorët do të rendisim bashkëpunimet e UBT në projektet: RisiAlbania, GEO-WB6, UNIDO, PHITO, READ, AADF, AKKSHI, AMORE-AL etj.

2.5 UBGREEN

Materialet e përgatitura për UBGreen duhet të jenë më specifike në tematikat që trajtojnë, më tërheqëse, aktuale dhe profesionale. Ato duhet të jenë të thjeshta, të kuptueshme për çdo kategori publiku dhe në koherencë me zhvillimet aktuale në vend.

Në disa raste është vërejtur mungesë e përshtatshmërisë midis materialit dhe natyrës së profilit të një portali. Për këtë arsye, kërkohet që përmbajtjet që publikohen në UBGreen të jenë në përputhje me formatin e një platforme informuese: të shkurtra, jo tepër teknike dhe të përshtatura për komunikim publik.

Gjatë vitit akademik 2024–2025 është shënuar një numër i ulët publikimesh nga stafi akademik në platformë. Kjo lidhet edhe me problematikat teknike të faqes, të cilat kanë sjellë pezullime të herëpashershme të saj.

2.6 NEWSLETTER

Newsletter-i mujor i Universitetit Bujqësor të Tiranës ofron një pasqyrë të shpejtë dhe të përmbledhur të aktiviteteve më të rëndësishme akademike, kërkimore dhe komunitare të universitetit. Ai mbulon ngjarjet kryesore të muajit, si leksione të hapura, konferenca, ërkshope, rezultate kërkimore, projekte bashkëpunimi dhe iniciativat studentore, njoftimet zyrtare, mundësitë e praktikave, bursave dhe aktivitetet që lidhen me jetën universitare.

Qëllimi i tij është të mbajë të informuar studentët, stafin dhe partnerët institucionalë mbi zhvillimet më të rëndësishme dhe kontributin e UBT-së në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor.

2.7 REKOMANDIME

Stafi akademik duhet të jetë aktiv në ofrimin e informacionit profesional dhe tematikave me interes publik, duke reflektuar zhvillimet në vend, rajon dhe botë. të propozojë tema, intervista, opinione dhe analiza për mediat, në përputhje me sezonin, ngjarjet aktuale dhe ekspertizën e tyre.

Të aktivizohet dhe zgjerohet vazhdimisht rrjeti i kontakteve verbale dhe joverbale për shpërndarjen e informacionit dhe promovimin e UBT. Të zhvillohen ura komunikimi me institucionet, organizatat, partnerët mediatikë dhe komunitetin akademik.

Krijimi i një strukture të organizuar të komunikimit të brendshëm mes fakulteteve, departamenteve, sektorëve dhe zyrave të UBT për: shkëmbim idesh dhe informacionesh, planifikimin e eventeve, hartimin e strategjive, propozuar nisma të përbashkëta, koordinimin e projekteve.

Fakultetet duhet të përgatisin një axhendë të përmuajshme të aktiviteteve kryesore (evente, konferenca, prezantime, punëtori, vizita studimore) që të shërbejë si bazë për promovim, vizibilitet dhe planifikim mediatik.

Pedagogët dhe studentët të angazhohen më shumë në krijimin e përmbajtjes për: faqen zyrtare të UBT, platformën UBGreen, rrjetet sociale duke u fokusuar te interesat e publikut, arritjet akademike, kërkimi shkencor dhe aktivitetet e tyre.

Të ngrihet ose të fuqizohet një forum studentor që përfaqëson zërin, kërkesat, idetë dhe problematikat e studentëve, duke u bërë pjesë aktive e komunikimit institucional dhe ambasadorët më të mirë të promovimit të institucionit.

Është e domosdoshme të ndërtohet një strategji marketingu e qartë dhe afatgjatë për promovimin e UBT, programeve të studimit, kapaciteteve kërkimore dhe impaktit shoqëror e ekonomik të universitetit.

Të vazhdojë zgjerimi i partneriteteve ndërkombëtare, programeve ndërkombëtare të studimit dhe mobiliteteve për studentë e staf akademik, bashkëpunimi në kërkimin shkencor dhe projektet ndërkombëtare.

Të zgjerohet dhe funksionalizohet databaza e kontakteve me biznese dhe institucione për: praktika mësimore, internshipe, punësim të studentëve, marrëveshje bashkëpunimi në çështje sociale, teknike dhe financiare.

Të promovohen dhe mbështeten punët kërkimore-shkencore me impakt ekonomik dhe social, që kanë potencial aplikimi në treg dhe komunitet.

Të krijohet kontakt i vazhdueshëm me shkollat e mesme në të gjithë vendin, ku përfaqësuesit e UBT të organizojnë prezantime, informim të drejtpërdrejtë dhe takime me nxënësit dhe mësuesit.

Të realizohen Open Day me maturantët dhe të forcohen kontaktet me gjimnazet për fushata informuese mbi programet e studimit dhe mundësitë që ofron UBT.

Çdo fakultet duhet të prodhojë të paktën një material në javë për platformën UBGreen. Edhe Instituti i Bankës Gjenetike të Bimëve të kontribuojë në mënyrë të rregullt, duke shfrytëzuar kapacitetet e larta për përmbajtje shkencore dhe informative.

3. ORGANIZIMI I LEKSIONEVE TE HAPURA.

Të dhëna për plotësimin dhe raportimin mbi leksionet e hapura të zhvilluara në nivel Departamenti, Fakulteti gjatë vitit 24 - 25.

Ky informacion të paraqitet në mënyre përshkruese dhe tabelare duke mbajtur në konsideratë minimalisht:

- a. Të dhëna lidhur me leksionet e hapura të zhvilluara në Fakultet, temat kryesore, periudha, si dhe të dhënat e paraqitura në tabelat si më poshtë.
- b. Të dhëna të paraqiten dhe me grafik për të evidentuar temat kryesore, sygjerrime, rekomandime lidhur me rëndësinë për kontakte dhe bashkëpunimin në funksion të procesit mësimor.

3.1 FAKULTETI EKONOMISË DHE AGROBIZNESIT

Mësimet e hapura me personalitete janë një prej aktiviteteve që zhvillon Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Për plotësimin e njohurive të studentëve gjatë vitit akademik 2024-2025 u zhvilluan leksione të hapura nga personalitete shqiptare në fusha të ndryshme si dhe lektorë të huaj lidhur me përdorimin e softëve dhe sistemeve në biznese, koncepte të rëndësishëm financiare, statistikore apo fushave të turizmit sikurse edhe administrator apo menaxherë të bizneseve më me zë të tregut turistik, të cilët sollën eksperiencën e tyre në këto fusha. Këto aktivitete janë tashmë të dokumentuara në mënyrë fotografike por edhe me rraport mbi programet konkrete të këtyre leksioneve pranë Dekanatit të FEA_s.

Kujtojmë se përfituesit kryesor nga këto leksione të frytshme kanë qenë studentët e FEA-s ku interaktiviteti i tyre ka qenë shumë impresionues.

Tabela Nr. 1. Leksionet e hapura sipas departamenteve, Dhjetor 24 – Nëntor 25.

Fakultet/ Departamenti	Pedagog	Tema	Periudha
Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural	Amelie Bourceret	Modelimi bioekonomik në mbështetje të vendimmarrjes publike në bujqësi	12.05.2025
	Prof. Asoc. Dr. Marya Peneva	Programet LEADER – sfidat e aplikimit në Bullgari	29.05.2025
	Prof Svetlana Saksonova	Ndërtimi i Buxhetit të Cash Flow dhe Buxhetit të Pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve	08.05.2025
	Dr. Iwona Pomianek	Politikat territoriale në BE	07.06.2025
Departamenti Menaxhim Turizmi Rural	Arben Llangozi	Dhuna në familje/ Njohja me institucionet perkatese përgjegjese, shkaqet, parandalimi - Raste praktike	14.01.2025
	Dr.Edlir ORHANI	Shqipëria si atraksion i turizmit kulturor dhe atij të diktaturës/Udhërrëfyesi turistik si promotor	18.03.2025
	Prof. Anna Mauzreko	Thematic villages in Europe – entrepreneurship in rural areas.	03.11.2025
	Prof. Anna Mazurek-Kusiak	Innovation in product and business promotion – event marketing	07.11.2025
	Shpresim Domi	Sistemet e menaxhimit të Njesive turistike akomoduese.	25.04.2025
Departamenti Matematikë dhe Inform	Prof. Iwona Pawlas	Doing business in intercultural environment with focus on negotiations	7-11.10.2024

	Reglend Xhango Entela Prifti	Cybersecurity Awareness Month	16.102024
--	---------------------------------	-------------------------------	-----------

Përveç leksioneve të hapura, pjesëmarrja e ekspertizës së huaj e nga trojet shqiptare duhet të rritet e zhvillohet në metrikë të rinj (psh simpozium organizuar nga departamenti), duke nxjerrë në pah diapazonin e mjeteve kërkimore në kushtet e sfidave të tregjeve, teknologjisë dhe institucioneve inovative dhe theksuar rolin e akademikëve për zgjidhjen e problemeve zhvillimore në vend. Programet e reja të financimit të kërkimit janë një mundësi për të energjizuar lidhjet me diasporën. Duhet specifikuar teknikisht zhvillimi i leksioneve të hapura duke përdorur platformat interaktive si Zoom, Microsoft Teams ose WebEx, përfshirë mundësinë për t'i regjistruar aktivitetet e leksioneve për rishikime e diskutime me studentët, stafin ose përfaqësues të biznesit e institucioneve. Mund të përfshihet zyra e IT për koordinimin e vendit të aktiviteteve me kohën dhe teknologjinë. Duhet të hartohet një kalendar ndërkombëtar i përbashkët pune, ku të përfshihen datat dhe temat e leksioneve të hapura, për të siguruar koordinim të lehtë me personalitetet jashtë vendit. Studentët duhet të nxiten për këto aktivitete, duke qenë të informuar e instruktuar paraprakisht nga pedagogët dhe kordinatorët e aktiviteteve për të diskutuar dhe përfutur eksperiencë kërkimore. Me të dhënat nga raportet përmbledhëse mbi çështjet e diskutuara mund të zhvillohen më tej projektet e kursit ose tezat e diplomave për mbrojtje, duke lidhur mësimdhënien me kërkimin

3.2 FAKULTETI MJEKËSISE VETERINARE

Gjatë vitit akademik 2024–2025, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka vijuar traditën e organizimit të leksioneve të hapura, një praktikë e konsoliduar që synon forcimin e dimensionit praktik, shkencor dhe bashkëpunues të procesit mësimor.

Këto leksione janë zhvilluar në nivel departamenti, duke përfshirë ekspertë të ftuar nga universitetet europiane, profesionistë të sektorit veterinar dhe specialistë të Shëndetit Publik Veterinar.

Qëllimi kryesor i këtyre leksioneve është thellimi i njohurive të studentëve dhe rritja e ndërveprimit mes akademisë dhe praktikës profesionale. Për secilin aktivitet, Fakulteti ka publikuar njoftime zyrtare në faqen web të FMV dhe të UBT-së, duke garantuar transparencë dhe akses për të gjithë të interesuarit.

Pjesëmarrësit kanë përfshirë studentë, ish-alumni, përfaqësues të institucioneve shtetërore, pronarë klinikash veterinarë, si dhe ekspertë të industrisë ushqimore dhe të sektorit blektoral.

Temat kanë qenë të orientuara drejt praktikës klinike, metodave moderne të diagnostikimit, Shëndetit Publik Veterinar dhe risive teknologjike në sigurinë ushqimore. Leksionet kanë nxitur hapjen e kanaleve të reja bashkëpunimi me institucione vendase e të huaja dhe kanë ndihmuar në forcimin e cilësisë së mësimdhënies në përputhje me standardet europiane.

Departamenti	Pedagogu	Tema	Periudha
Moduleve Paraklinike	Carlota Marini	Anestezia Lokale dhe pergjithëshme	Qershor 2025
Moduleve Klinike	Luis Felipe Correa	Menaxhimi i plagëve dhe Frakturave në Kuaj	Prill 2025
	Fabrizio Dini	Diagnostikimi dhe terapia e Patologjive Nervore	Qershor 2025
	Jose Luis Valverde	Mykotoksinat dhe Siguria Ushqimore	Dhjetor 2024

Shëndetit Publik Veterinar	Eleni Malissiova	Innovative digital tools in meat technology	Qershor 2025
	Maria Aleksandraki	Develop of Goat milk yogurt	Qershor 2025
	Grazia Greco	Semundjet Infektive	Nëntor 2025
	Maria Tempesta	Siguria ushqimore	Nëntor 2025
	Elisabeta Bonerba	Vlerësimi i riskut për substancat kimike	Nëntor 2025
	Valentina Terio	Patologjitë ushqimore që shkaktohen nga virusët.	Nëntor 2025

Tabela 2. Leksione te hapura FMV

Temat e zgjedhura pasqyrojnë qasjen e Fakultetit për të ofruar një gamë të gjerë kompetencash profesionale dhe shkencore. Ato përfshijnë:

Ekspertizë klinike të avancuar – (ortopedi e kuajve, neurologji veterinar, anesteziologji) të rëndësishme për praktikën veterinarë të përditshme.

Shëndet Publik Veterinar dhe Siguria Ushqimore – që lidhet me kërkesat e tregut dhe standardet europiane.

Përdorimin e teknologjive digjitale – një komponent modern që mbështet laboratorët, industrinë ushqimore dhe monitorimin e zinxhirit ushqimor.

Tematika të inovacionit në produktet me origjinë shtazore, që lidhen drejtpërdrejt me sektorin e përpunimit në Shqipëri.

Rekomandime dhe sugjerime për vijimësinë

Zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar: Ftesa e ekspertëve të huaj duhet të vijojë, pasi ka pasur ndikim pozitiv në rritjen e cilësisë akademike dhe përditësimin e njohurive në linjë me zhvillimet globale.

Rritja e temave lidhur me One Health: Sugjerohet shtimi i leksioneve mbi zoonozat, antimikrobikët, epidemiologjinë dhe qasjen One Health, në përputhje me prioritetet e BE-së dhe EAEVE.

Forcimi i lidhjes me industrinë ushqimore: Temat mbi analizën e riskut, sigurinë ushqimore dhe teknologjitë inovative duhet të shpërndahen më shumë edhe si workshop-e praktike në bashkëpunim me operatorë ushqimorë.

Mbledhja e të dhënave për efektivitetin e leksioneve: Sugjerohet krijimi i një forme vlerësimi të shkurtër nga studentët dhe pjesëmarrësit për të matur efektin dhe për të përmirësuar planifikimin.

3.3 FAKULTETI SHKENCAVE PYJORE

Gjatë vitit akademik 2024-2025 në ambientet e Fakulteti të Shkencave Pyjore janë organizuar një sere leksionesh të hapura me të ftuar të ndryshëm në fusha të ndryshme të sektorit pyjor dhe atij të përpunimit të drurit.

Cdo fillim viti zyra e komunikimit prane këtij Fakulteti kërkon nga Departamentet një liste me personalitet të ftuar në Leksione të hapura me qëllim ndarjen e eksperiencave të të ftuarve dhe përfshirjen e një grupi sa më të gjere audience, duke përfshirë stafin akademik dhe studentet të cikleve të ndryshme

Gjatë periudhës 2024÷2025 në ambientet e FSHP-së janë zhvilluar orë leksionesh nga:

Projekti “Tree for Lura” - Ekspertët prezantojnë qasjet moderne të restaurimit pyjor

Në Mars 2025, në Fakultetin e Shkencave Pyjore të Tiranës u zhvillua një leksion i hapur nga ekspertët e projektit të ripyllëzimeve në zonat e Lurës dhe Voskopojës, dy prej peizazheve më të ndjeshme ndaj degradimit pyjor në Shqipëri. Gjatë leksionit, specialistët prezantuan përvojat e tyre

në restaurimin ekologjik, metodat e përdorura për përzgjedhjen e specieve vendase dhe qasjet afatgjata për rritjen e qëndrueshmërisë së ekosistemeve.

Studentët u njohën me sfidat kryesore, si dëmtimet historike të sipërfaqeve pyjore, presioni antropogjen, ndryshimet klimatike dhe vështirësitë në mbikëqyrjen e parcelave të reja të mbjella. Në të njëjtën kohë, ekspertët theksuan rëndësinë e monitorimit të vazhdueshëm, përfshirjes së komunitetit lokal dhe përdorimit të teknologjive moderne për menaxhimin e pyjeve të restauruara. Leksioni u vlerësua si një mundësi e rëndësishme praktike për studentët, duke i lidhur konceptet e restaurimit pyjor me projekte konkrete në terren dhe duke i frymëzuar për angazhim të mëtejshëm në menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore.

Shoqata e Pylltarëve Irlandezë

Në Shtator 2025, Fakulteti i Shkencave Pyjore në Tiranë priti një delegacion të Shoqatës së Pylltareve Irlandeze, në kuadër të një vizite zyrtare për shkëmbim ekspertize dhe forcim bashkëpunimi. Gjatë takimit, pylltarët irlandezë u njohën me projektet kërkimore dhe praktikën e menaxhimit të pyjeve në Shqipëri, ndërsa ndanë përvojat e tyre në certifikimin pyjor dhe teknologjitë moderne të monitorimit të ekosistemeve.

Vizita përfshiu gjithashtu një udhëtim studimor në një zonë pyjore pranë Tiranës, ku u diskutuan sfidat e menaxhimit të pyjeve dhe mundësitë për projekte të përbashkëta europiane. Të dyja palët shprehën interes për vazhdimin e bashkëpunimit përmes trajnimeve, kërkimit dhe shkëmbimeve profesionale.

UNDP Albania

Në Nëntor 2025, në Fakultetin e Shkencave Pyjore të Tiranës u zhvillua një leksion i hapur nga ekspertë të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), i fokusuar në përdorimin e teknologjive të reja për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje.

Ekspertët prezantuan **Smart Forest Fire Application**, një platformë inteligjente që mundëson zbulim të hershëm të zjarreve, monitorim satelitor, analizë në kohë reale dhe koordinim më të shpejtë të ndërhyrjeve në terren. Studentët dhe pedagogët u njohën me mënyrën se si të dhënat digjitale, sensorët, imazhet termike dhe modelet e parashikimit mund të përdoren për të reduktuar dëmet dhe për të përmirësuar reagimin ndaj emergjencave pyjore.

Leksioni solli përvoja praktike nga projektet e UNDP-së në rajon dhe theksoi rëndësinë e integritetit të mjeteve teknologjike në politikën e menaxhimit të pyjeve. Aktiviteti u vlerësua si një mundësi e çmuar për studentët, duke i lidhur ngushtë teorinë e silvikulturës me sfidat moderne të ndryshimeve klimatike.

Ark. Orest Prifti, zyra e projektimit BROS ARCHITECTURE

Në Fakultetin e Shkencave Pyjore u zhvillua në muajin Maj një leksion i hapur nga arkitekti **Orest Prifti**, përfaqësues i studios projektuese **BROS ARCHITECTURE**, i cili ndau me studentët eksperiencën e tij në fushën e dizajnit bashkëkohor të mobiljeve. Gjatë prezantimit, ai paraqiti projekte inovative të realizuara në praktikë, duke theksuar rolin e kreativitetit, funksionalitetit dhe përdorimit të materialeve natyrore në procesin e projektimit.

Studentët u njohën me sfida reale të projektimit, fazat nga koncepti deri te produkti final, si dhe me tendencat e reja të dizajnit që synojnë qëndrueshmërinë dhe efikasitetin. Leksioni u vlerësua si një mundësi e çmuar për t'i afruar studentët me industrinë dhe për t'i frymëzuar drejt qasjeve më inovative dhe praktike në fushën e dizajnit të mobiljeve.

Prof. Piotr Beer & Ing. Sylwia Olenska – Universiteti i Shkencave të Jetës së Varshavës (SGGĖ)

Në kuadër të programit **Erasmus+**, në Qershor, Fakulteti i Shkencave Pyjore priti profesorin **Piotr Beer** dhe inxhinieren **Sylwia Olenska** nga Universiteti i Shkencave të Jetës në Varshavë, të cilët zhvilluan dy leksione të hapura me fokus në dizajnin dhe vlerësimin teknik të produkteve të drurit.

Prof. **Piotr Beer** prezantoi disa tema mbi “*Dizajni i mobiljeve sipas rregulloreve të BE*”, duke shpjeguar standardet europiane të sigurisë, ergonomisë dhe qëndrueshmërisë, si dhe ndikimin e tyre në procesin e projektimit bashkëkohor.

Ndërsa **Ing. Sylëia Olenska** mbajti disa leksione mbi “*Analiza e rezistencës dhe vlerësimi i produkteve të drurit*”, ku paraqiti metoda praktike të testimit, kriteret teknike të performancës dhe rëndësinë e certifikimit për tregjet europiane.

Leksionet u pritën me interes të madh nga studentët dhe pedagogët, duke ofruar një përvojë të vlefshme ndërkombëtare dhe duke forcuar bashkëpunimin akademik mes dy institucioneve.

Prof. Paëel Czarniak – Universiteti i Shkencave të Jetës së Varshavës (SGGË)

Në kuadër të bashkëpunimit Erasmus+, Fakulteti i Shkencave Pyjore priti gjatë muajit Tetor profesorin **Paëel Czarniak** nga Universiteti i Shkencave të Jetës në Varshavë, i cili zhvilloi disa leksione të hapura për studentët dhe pedagogët e Departamentit të Industrisë së Drurit.

Në leksionet e para, Prof. Czarniak trajtoi temën “**Energjia nga biomasa**”, duke paraqitur teknologjitë moderne të shfrytëzimit të biomasës, avantazhet energjetike dhe rolin e saj në tranzicionin drejt burimeve të qëndrueshme të energjisë.

Grupi i dytë i leksioneve u fokusua te **produktet speciale të drurit**, me theks të veçantë te **vozat e drurit**, ku profesori prezantoi veçoritë teknike, përdorimet tradicionale dhe potencialin e tyre në tregjet artizanale dhe industriale.

Vizita u vlerësua si një mundësi e rëndësishme për pasurimin e përvojës akademike të studentëve dhe forcimin e lidhjeve ndërkombëtare në fushën e shkencave pyjore dhe përpunimit të drurit.

Prof. Emeritus Salim Hiziroglu – Oklahoma State University (SHBA)

Fakulteti i Shkencave Pyjore mirëpriti Prof. Emeritus **Salim Hiziroglu** nga *Oklahoma State University (SHBA)*, i cili zhvilloi dy leksione të hapura të fokusuara në inovacionin dhe qëndrueshmërinë në industrinë e drurit.

Në leksionin e parë, profesori prezantoi temat rreth **plakave me bazë druri (Eood Composites)**, duke analizuar teknologjitë moderne të prodhimit, performancën mekanike dhe rolin që këto materiale kanë në industrinë bashkëkohore të ndërtimit dhe mobiljeve.

Leksioni i dytë u përqendrua në **përdorimin e lëndëve drusore të nënvlerësuara**, duke theksuar potencialin e këtyre resurseve për të krijuar produkte inovative dhe të qëndrueshme. Prof. Hiziroglu solli shembuj praktikë nga kërkimi shkencor dhe industria amerikane, duke nënvizuar rëndësinë e shfrytëzimit efikas të burimeve pyjore.

Vizita u vlerësua si një mundësi e çmuar për studentët dhe pedagogët, duke ofruar perspektiva të reja ndërkombëtare në përpunimin e drurit dhe zhvillimin e produkteve të qëndrueshme.

Mimoza Vokshi – Njësia Kombëtare Ozonit

Në Nëntor 2025, në Fakultetin e Shkencave Pyjore të Tiranës, u zhvillua një aktivitet nga Njësia Kombëtare e Ozonit (NKO) me temë “Femrat dhe Aksioni për Klimën: Protokollin e Montrealit dhe roli i RRR për një të ardhme të qëndrueshme.”

Koordinatoria e NKO-së, Znj. Mimoza Vokshi, e evidentoi këtë aktivitet me një rëndësi të veçantë, pasi synon të fuqizojë vajzat dhe gratë si aktore kyçe në mbrojtjen e mjedisit dhe në luftën kundër ndryshimeve klimatike, si dhe u ofron pjesëmarrëseve njohuri praktike dhe inspirim të drejtpërdrejtë për t’u angazhuar në iniciativa që promovojnë teknologji të pastra dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Gjatë aktivitetit u prezantuan arritjet e Protokollit të Montrealit, duke nënvizuar rëndësinë e reduktimit, ripërdorimit dhe riciklimit (RRR) si mjete kyçe në luftën kundër ndryshimeve klimatike.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të diskutojnë praktika të qëndrueshme, shembuj të suksesshëm nga komunitetet lokale dhe mundësitë që ofron angazhimi i grave në proceset vendimmarrëse mjedisore. Aktiviteti u vlerësua si një hap i rëndësishëm drejt forcimit të ndërgjegjësimit publik dhe promovimit të një kulture më të përgjegjshme ndaj klimës dhe mjedisit.

Tabela 3. Të dhëna lidhur me leksionet e hapura në Fakultetin e Shkencave Pyjore

Departamenti	Pedagog	Tema	Periudha
Departamenti i Pyjeve FSHP	UNDP Albania	Smart Forest Fire Application/menaxhimi i zjarreve në pyje në kohë reale	Nentor 2025
	Shoqata e Pyltarëve Irlandezë	An overview of Faculty of Forestry Sciences and Albanian Forestry Sector	Shtator 2025
Përditësimi i marrëveshjeve mbi praktikën profesionale.
Rinovimi i marrëveshjeve më të vjetra dhe formalizimi i kontakteve me protokolle bashkëpunimi.
Ndërtimi i projekteve të përbashkëta për aplikime në AKKSHI, IPARD apo fondet e inovacionit.
Një Newsletter 1ose 2 herë në vit për bizneset partnere. Ftesa për aktivitetet e Fakultetit (Konferenca, Ditët e Karrierës, Workshope)

Tabela 11: Të dhëna mbi marrëveshjet me institucionet/ bizneset për realizimin e praktikave mësimore, temave të diplomave për çdo departament, Fakultet

Nr.	Fakulteti	Biznesi/Institucioni që ofron praktikën/ internship/diplomen per studentet	Bachelor	Master Shkencor/Profesional
1	DSHA/ FBM	Instituti i Resurseve Gjenetike	5	Studentet e Masterit Shkencor zhvillojne vetem Tezen e Masterit
2	DSHA/ FBM	Farmaci Bujqesore Nuri Sita	1	
3	DSHA/ FBM	Bashkia Konispol	1	
4	DSHA/ FBM	AREB_Korce	1	
5	DSHZ/ FBM	AZ GROUP		
6	DSHZ/ FBM	AFA shpk		
7	DSHZ/ FBM	Austria Praemix		
8	DSHZ/ FBM	AGRI-ZOO Sh.p.k,		
9	DSHZ/ FBM	Bletaria Spaho		
10	DSHZ/ FBM	Ferma TUSHAJ		
11	DSHZ/ FBM	DRIZA Sh.p.k		
12	DSHZ/ FBM	Istrefi Sh.p.k		
13	DSHZ/ FBM	MYZO Farm		
14	DSHZ/ FBM	Tris ALB sh.p.k,		
15	DSHZ/ FBM	Ferma Kapaj		
16	DSHZ/ FBM	Resuli Farm		
17	DSHZ/ FBM	VJEN sh.p.k		
18	DSHZ/ FBM	Ferma Prenci		
19	DSHZ/ FBM	Ferma Shelqetja		
20	DSHZ/ FBM	FLUEDA		
21	DSHZ/ FBM	Ferma Tufa		
22	Dep Akuakultures	Ekonomia e Prodhimit te rasantit te koranit , Lin Pogradec (DSHPA, Drejtoria e Sherbimeve te Peshkimit dhe Akuakultures. Ministria Bujqesise, Ujrave dhe Zhvillimit Rural .	12	
23	Dep Akuakultures	Ekonomia e Prodhimit te troftave, Prenjas. Me administrator Ragip Lacka	12	7 MSC Shkencor 10 Master Profesional
24	Dep Akuakultures	Porti Peshkimit, Dures. (DSHPA, Drejtoria e Sherbimeve te Peshkimit dhe Akuakultures. Ministria Bujqesise, Ujrave dhe Zhvillimit Rural .		7 MSC Shkencor 10 Master Profesional

Gjithashtu, stafi akademik i FBM ka kontribuar aktivisht në promovimin e programeve të studimit në territor, nëpërmjet takimeve në shkolla, pjesëmarrjeve në panairë arsimore dhe bashkëpunimeve me institucione e organizata që mbështesin fushën e mjedisit dhe bujqësisë.

5. KOMUNIKIMI, AKTIVITETE DHE DALJET NE MEDIA. RAPORTIMI SIPAS FAKULTETEVE

Të dhëna mbi aktivitet e realizuara:Llojet e aktiviteve, takimeve promovuese për cdo fakultet.

numrin i daljeve në media, evidentoni temat kryesore, angazhimi i stafit. pjesëmarrja në panairë, vlerësim i angazhimit të stafit dhe studentëve. Ky informacion të paraqitet në mënyrë përshkruuese dhe tabelare, duke mbajtur në konsideratë minimalisht të dhënat e paraqitura në tabelat si më poshtë:

5.1 FAKULTETI BUJQËSISË DHE MJEDISIT

Gjatë vitit akademik 2024–2025, aktivitetet e komunikimit në rrjetet sociale të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit (faqja fbm_ubt në Instagram dhe Facebook) janë intensifikuar ndjeshëm, në bashkëpunim me stafet akademike të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit (Figura 2).

Në kuadër të komunikimi, u realizuan postime të rregullta për pasqyrimin e:aktiviteteve mësimore dhe kërkimore,leksioneve të hapura me profesorë vendas dhe të huaj,praktikave në terren dhe laborator,promovimit të programeve të studimit, pjesëmarrjes në konferenca, projekte dhe trajnime,aktiviteteve studentore dhe ndërjegjësuëse për mjedisin.Përveç publikimeve në formë postimesh dhe reels, u shfrytëzua edhe formati i story-ve ditore, për të ofruar përmbajtje dinamike dhe afër realitetit të jetës studentore e akademike. Këto story përfshinë vizita në ferma, në stacionin meteorologjik, promovime të programeve të masterit dhe momente nga aktivitetet praktike të studentëve në terren.Në total, gjatë vitit akademik u realizuan rreth 200 publikime në rrjete sociale, përfshirë video, foto dhe story, të cilat arritën një ndërveprim të lartë me ndjekësit (pëlqime, komente, shpërndarje). Aktualisht, faqja fbm_ubt numëron mbi 1,700 ndjekës aktivë, me një rritje të qëndrueshme të audiencës gjatë gjithë vitit. Audienca kryesore mbetet grupi i studentëve dhe kandidatëve të rinj për regjistrim, por përmbajtja është ndjekur gjerësisht edhe nga alumni, partnerë institucionalë, dhe publiku i gjerë, duke e bërë faqen fbm_ubt një platformë të qëndrueshme promovimi për departamentin dhe fakultetin. Komunikimi me ndjekësit është mbajtur i vazhdueshëm, duke përgjigjur në kohë reale për çdo kërkesë apo informacion që lidhet me programet e studimit, aplikimet, aktivitetet dhe eventet e fakultetit. Kjo ka ndihmuar në krijimin e një marrëdhënieje të afërt me studentët aktualë dhe të rinj, si dhe në forcimin e imazhit të fakultetit si një institucion modern, i hapur dhe bashkëkohor në komunikim.

Tabela 12: Llojet e aktiviteteve, takimeve promovuese për cdo fakultet

<i>Llojet e aktiviteteve, takimeve promovuese për çdo Fakultet .</i>					
Nr.	Fakulteti	Lloji i aktiviteteve, takimeve promovuese	Promovim mediatik, intervista, dalje ne media	Rrjete sociale (Instagram/ Facebook)	Komente
1	DSHA/FBM	https://youtu.be/-l5CTC87YV4?si=Eaz7OvpW2r2C2FKf	Dalje ne media	SCAN Tv; Youtube	29.09.2025
2	DSHA/FBM	https://www.youtube.com/watch?v=Wcf9cl3npx4	Dalje ne media	ABC News	15.11.2025
3	DSHA/FBM	https://www.youtube.com/ëatch?v=v2FoyuFP49A	Dalje ne media	Top channel	Prill 2025
4	DSHA/FBM	https://top-channel.tv/2025/09/17/lufta-me-pesticidet-ne-bujqesi-eksperti-qe-bujku-ti-qendroje-larg-pompes-se-helmit-duhet-ndeshkim/	Dalje ne media	Top channel	17.09.2025

Llojet e aktiviteteve, takimeve promovuese për çdo Fakultet .					
Nr.	Fakulteti	Lloji i aktiviteteve, takimeve promovuese	Promovim mediatik, intervista, dalje ne media	Rrjete sociale (Instagram/ Facebook)	Komente
5	DSHA/FBM	https://alert.al/bimet-medicinale-ibralliu-nje-nga-industrite-me-rritjen-me-te-rendesishme-vitet-e-fundit/	Dalje ne media	Ora News	Qershor 2025
7	FBM/ DSHA	Promovim i programeve te studimit ne Shkollat e mesme (Kamez, Tirane, Cerrik-Elbasan, Lushnje, Divjake)	Promovimi I programeve te studimit eshte realizuar nepermjet fletepalosjeve.	Me shkollat e Mesme	Promovimi eshte realizuar gjate periudhes - Maj 2025
8	FBM/ DSHA	Promovimi i progarmeve ne Ditet e Maturanteve, ne te gjitha rrethet e planifikuara nga MASR	Stafi i DSHA ka marre pjese ne menyre te organizuar ne te gjitha shkollat e mesme dhe profesionale bujqesore te qyteteve te permendura	Me shkollat e Mesme	Mars-Prill 2025
9	FBM/ DSHA	Panairi Work & Study në Tiranë	Moren pjese stafi akademik (me alternime) dhe nje studentet. Promovimi me fletepalsoje	Me shkollat e Mesme	Maj 2025 Moren pjese staf akademik dhe studente

Tabela 13. Të dhëna për aktivitetet në median e shkruar dhe elektronike për vitin 2024-2025.

Nr .	Pedagogu	Lloji i aktivitetet, takimit promovues	Promovim mediatik, intervista, dalje në media, artikull në gazetë	Komente, linku
1	F. Sallaku	Interviste televizive, Dritare TV (me Rudina Xhunga)	Rëndësinë e studimeve në këtë Universitet, hapësirave dhe mundësive që të jep UBT	https://www.facebook.com/story.php?story_fbid=3138091466324955&id=100003723979310&mibextid=oFDknk&rdid=9NxsO7JgnCLlmtqp#
2	F. Sallaku	Interviste televizive, Report TV	1 semestër në BOKU! Rektori i UBT jep lajmin e mirë: Europën po ua sjellim këtu studentëve!	https://www.youtube.com/ëatch?v=gH8Vn6shDë
3	F. Sallaku	Interviste televizive, A2 CNN	Rektori Fatbardh Sallaku tregon në A2CNN programin e ri akademik	https://www.youtube.com/ëatch?v=7Ev0ë56m6qo
4	F. Sallaku	Interviste televizive, Top Channel	Studentë sipas tregut / Ndryshimet në UBT, rektori Sallaku: Ofertë e re akademike	https://www.youtube.com/ëatch?v=UpCFëZKi8Sk
5	F. Brahushi	Interviste televizive, TV Klan, Aldo Morning Shoë	Cilësia e ajrit	https://www.instagram.com/reel/DIvVBërtzsZ/?igsh=dGdsdDNhamNuNë1ë

6	F. Brahushi	Artikull në Gazetën Panorama	Çështja e mbetjeve të pesticideve në fruta-perime	https://www.panorama.com.al/ceshtja-e-mbetjeve-te-pesticideve-ne-fruta-perime/#gsc.tab=0
7	F. Brahushi	Interviste televizive, Channel Top	Efektet e frikshme të pesticidit të ndaluar, çfarë shkaktojnë mandarinat	https://www.youtube.com/ëatch?app=desktop&si=vQQM6dEun64sjqHh&fbclid=PAZXh0bgNhZĒ0CMTEAc3J0YĒZhcHBfaĒQPMTI0MDI0NTc0Mjg3NDE0AAGnsJ9nRN eJAJ SXN2A0jjMTngKZ Zuflr- l3JXq36Mkz0me2xxppyls1JY8H94 M aem X4Ar0zOY aC4NyrQazPM 8YĒ&v=dFqPHD6L3Ē4&feature=youtu.be
8	F. Brahushi	Interviste televizive, Vizion + në ditën e tokës	Toka bujqësore në rrezik, ekspertët: Është e pakët dhe shpesh dëmtohet duke sjellë pak prodhim	https://www.youtube.com/ëatch?v=sOmFnZ-ntyU
9	S. Shallari	Interviste televizive, TVSH, Emisioni Auditor Arsimi	Universiteti bujqësor dhe Bokut - 8 Mars 2025 Auditor arsimi	https://www.youtube.com/ëatch?v=JhqhNPIUf2Y
10	A. Bani	Interviste televizive	These Plants Could Change the Future of Mining	https://www.youtube.com/ëatch?v=NHMJVXiĒBEA
11	U. Abazi	Interviste televizive, TV MCN	Probleme me sigurinë ushqimore. Më shumë probleme kemi me ruajtjen dhe higjienizimin e produkteve blegtorale, sesa me pemët.	https://www.youtube.com/ëatch?v=S0PZ6eTPHIQ
12	U. Abazi	Interviste televizive, TV MCN	Cilësia e ujërave në Shqipëri. Zona mes Durrësit dhe Kavajës, më problematikja për cilësinë e ujit	https://www.youtube.com/ëatch?time_continue=6&v=Q-65fcĒS vY&embeds_referring_urn=https%3A%2F%2Fwww.mcmtv.al%2F&source_ve_path=MTM5MT E3LDEzOTExNyĒyODY2Ng
13	U. Abazi	Interviste televizive, TVSH,	Cilësia e ujërave në Shqipëri - 26 tetor 2024 "Auditor arsimi" në RTSH	https://www.youtube.com/ëatch?app=desktop&si=hqaxuvFEbvĒX8Ac3&fbclid=PAZXh0bgNhZĒ0CMT EAc3J0YĒZhcHBfaĒQPMTI0MDI0NTc0Mjg3NDE0AAGn665fe7iko MxI0ox957qVxY6TQgn5iQj7DnB UxK0BilPsMk1QAc5GkIIRD3M aem 5veADJsHMĒYNspRmDbDf Jg&v=MZ-aSgLMZ oY&feature=youtu.be
14	A. Maçi	Interviste televizive, TVSH, Emisioni Auditor Arsimi	Universiteti bujqësor dhe Bokut - 8 Mars 2025 Auditor arsimi	https://www.youtube.com/ëatch?v=JhqhNPIUf2Y
15	L.Papa	Interviste TV-Clan	Programi Pro Business Numri i krereve dhe blegtoria	https://www.youtube.com/ëatch
16	F.Gjoka	Artikull në Gazetën Dita	Nga pasioni te profesioni: Maturantë zgjidhni programin tuaj të studimeve në UBT	
17	F.Gjoka	Gazeta Pnorama, Nov 16, 2024	Metalet toksike, kërcënimi i padukshëm	

18	F.Gjoka	Gazeta Fjala, 2025/07/27	Nga pasioni te profesioni: Zgjidhni programin tuaj të studimeve ne UBT	https://r.search.yahoo.com/_ylt=Aë_rFCQOijBxpLQIAR6BXNyoA;_ylu=Y29sbëNiZjEEcG9zAzUEdnRpZAMEc2VjA3Ny/RV=2/RE=1764661667/RO=10/RU=https%3a%2f%2ffjala.al%2f2025%2f07%2f27%2fnga-pasioni-te-profesioni-zgjidhni-programin-tuaj-te-studimeve-ne-ubt%2f/RK=2/RS=7LHSc040lfë05NGEpaagKiuHNdg-
19 8	F.Gjoka	Mjedi Sot, Maj 20, 2025	Interviste per Gazeten Fjala, Shqipëria Tkurret: Erozioni po na “vjedh” territorin	Shqipëria Tkurret: Erozioni po na “vjedh” territorin – Mjedi Sot
20	F.Gjoka	Interviste televizive, Vizion + në ditën e tokës	Toka bujqësore në rrezik, ekspertët: Është e pakët dhe shpesh dëmtohet duke sjellë pak prodhim	https://www.youtube.com/ëatch?v=sOmFnZ-ntyU
21	A. Erebara	Rrejtet sociale Instagram dhe Facebook	Janë kryer mbi 50 postime, në formë poster apo video (reels) dhe mbi 200 story në rrejtet sociale Instagram dhe Facebook,	https://www.instagram.com/fbm_ubt?igsh=aHp3OËk1aHFjazyx&utm_source=qr
22	Ardian Maci	Opinion mbi analizat e lendes aktive ne plehtrat kimike	Ora Neës	
24	E. Demiraj	6-Video/postime/pro movime	Insagram/Facebook FBM	https://www.facebook.com/share/p/1CkEbHpECe/ https://www.instagram.com/p/DOoEbSvDcë_kcg6bPOfKiFeNVIBCa-mlDOgrEQ0/?igsh=MËlqNËFyMnN6MDB4MQ==
25	E. Demiraj	Pjesemarres ne Panairin "Ëork and study", Elbasan, Prezantim i ofertes akademike UBT 2025–2026	Pallati i Sportit “Tomorr Sinani”	
26	E. Demiraj	Interviste TV Klan, Emisioni Stop	Mbetjet Spitalore dhe Rreziku ne QSUT dhe Shendet Publik	https://www.youtube.com/ëatch?v=Y5ouKjoSjZk
27	Kh. Sema	Takim informues në shkollen e mesme bujqesore “Rakip Kryeziu”, Fier	prezantim i ofertes akademike UBT 2025–2026	
28	L.Papa D,Bode	Takim informues në shkollen e mesme Kamez	prezantim i ofertes akademike UBT 2025–2026	
29	Kh. Sema	Pjesemarres ne Panairin "Ëork and study", Lushnje	Prezantim i ofertes akademike UBT 2025–2026	
30	N. Malo	Takim në shkollën e mesme "Arif Halil Sulaj", Mamurras	Prezantim i ofertes akademike UBT 2025–2026	
		Panairi "Ëork and Study", Fier	Prezantim i ofertes akademike UBT 2025–2026	

		Panairi "Eork and Study", Vlorë	Prezantim i ofertes akademike UBT 2025–2026	
31	F. Huqi	Leksion i hapur për nxënësit e shkollës "Emin Duraku" mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, riciklimit dhe uljes së ndotjes	Postim në LinkedIn dhe Facebook nga Intesa Sanpaolo Bank Albania (11 dhjetor 2024)	(8) Activity Fatos Huqi LinkedIn
32	F, Huqi	Takime informuese në gjimnazet "Naim Frashëri" dhe "Leonik Tomeo", prezantimi i ofertës akademike UBT 2025–2026	Postim në faqen zyrtare Instagram nga FBM_UBT (16 maj)	Instagram

Aktivitetet në media

FBM ka pasur **gjashtë dalje mediatike** në televizione kombëtare si SCAN TV, ABC Neës, Top Channel dhe Ora Neës, Clan . Këto intervista kanë trajtuar tema të rëndësishme të bujqësisë, pesticideve dhe bimëve mjekësore, duke rritur ndjeshëm profilin publik të fakultetit, si dhe trajtimin e sfidave të blegtorisë. Link-et e intervistave dëshmojnë përfshirjen e vazhdueshme të stafit akademik në debatin publik përgjatë periudhës Prill–Nëntor 2025.

Promovimi i programeve të studimit në shkollat e mesme

Gjatë muajve **Mars–Maj 2025**, stafi i FBM ka realizuar një fushatë të organizuar promovimi në shkollat e mesme dhe ato profesionale bujqësore në Kamëz, Tiranë, Cërrik–Elbasan, Lushnjë dhe Divjakë. Promovimi është kryer përmes takimeve informative dhe shpërndarjes së fletëpalosjeve. Ky aktivitet ka pasur synim rritjen e interesit të maturantëve për programet bujqësore dhe mjedisore.

Panairi "Work & Study" në Tiranë

Në Maj 2025, stafi dhe studentët përfaqësuan fakultetin në këtë panair kombëtar, duke ofruar informacione promovuese dhe materiale informuese për programet e studimit. Kjo ka shërbyer si kanal i rëndësishëm për komunikim direkt me maturantët dhe prindërit e tyre.

5.2 FAKULTETI EKONOMISË DHE AGROBIZNESIT

Një nga objektivat e zyrës së Marrëdhënieve me Institucionet dhe Publikun pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit ka qënë rritja e vizibilitetit, vënia në qendër të vëmendjes së kësaj qendre ekselence me reputacion të lartë në nivel kombëtar e rajonal, rritja e besueshmërisë dhe promovimi i shërbimeve dhe programeve të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit për publikun. Në FEA në bashkëpunim me zyrën e Karrierës dhe Alumni u ngritën grupe pune, u hartua një plan promovimi, u përgatitën materiale promovuese si fletëpalosje, broshurë e detajuar me programet e studimit dhe informacione në lidhje me fushat e punësimit të të diplomuarve në

FEA. Të dhënat tregojnë se komunikimi dhe aktivitetet promovuese janë zhvilluar përmes disa kanaleve kryesore si : intervista televizive, pjesëmarrje në aktivitete promovuese, takime ballë për ballë, kontaktet me këshilluesit e karrierave në gjimnaze dhe përdorim i rrjeteve sociale. Në këtë proces ka pasur një angazhim të dukshëm të stafit akademik, i cili ka kontribuar në rritjen e vizibilitetit të programeve të studimit dhe në orientimin e kandidatëve të rinj.

Gjithashtu janë bërë disa dalje në disa media nga stafi akademik i FEA gjë që ka rritur vizibilitetin e FEA. Kjo është një pikë e cila synohet të forcohet në të ardhmen si një mundësi e mirë e rritjes së besueshmërisë në këtë institucion.

Pjesëmarrja në panaire ka qenë një nga aktivitetet e stafit të FEA. Të organizuar në grupe anëtarë të stafit akademik kanë promovuar programet në takimet nga afër me studentët dhe prindërit e tyre që në panairet WORK & STUDY dhe në Panairin e Bujqësisë. Në këto panaire u informuan studentët dhe jo vetëm, lidhur me programet e studimit Bachelor, Master. Njëkohësisht u dhanë informacion edhe mbi mundësitë e punësimit në të ardhme të cilat janë në sektorin publik (institucione publike në nivel qendror apo lokal), sektori privat (njësi ekonomike private agrobiznesi, agroturizëm, OJF, etj), Institucione apo organizma financiare (institucione financiare, banka, etj.), agjenci të zhvillimit rural dhe shërbim këshillimor dhe/ ose sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimi.

Një rëndësi e veçantë ju dha dhe përafrimit të programeve me Universitetin Boku, Vjenë.

Tabela Nr. 14: Llojet e aktiviteteve, takimeve promovuese për FEA gjatë periudhës Dhjetor 2024-Nëntor 2025

Nr.	Fakulteti	Lloji i aktiviteteve, takimeve promovuese	Promovim mediatik, intervista, dalje ne media	Rrjete sociale (Instagram/ Facebook)	Komente
1	FEA- DEPZHR	Promovim i programeve të studimit UBT. Panairi studentor Fier Dr. Aljula Gjeloši			21 mars 2025
2	FEA- DEPZHR	Informim dhe regjistrim studentesh Dr. Aljula Gjeloši			9 shtator 2025
3	FEA- DEPZHR	Takim informues ne ambientet e FEA ne maturan të shkollës se mesme Domje. Dr. Alban Jaupi			21 maj 2025
4	FEA- DEPZHR	Intervistë Pro Business Prof Fatmir Guri keshillon fermeret	Dalje per fermen		https://www.youtube.com/watch?v=8Vkf_mRgwuec?si=oykvXOc6QHmwuk2d
5	FEA- DEPZHR	Takim me maturan të shkollës së mesme "John F. Kennedy"			
6	FEA- DEPZHR	Takime informuese per programet Master me			

		studentet Bachelor e FEA K3,			
7	FEA- DEPZHR	Pjesëmarrje në Panairin Work &Study ,			27 Shkurt -28 Mars 2025
8	FEA- DEPZHR	Pregatitje materiale promovuese (Flete palosje, postera etj) per Departamentin EPZHR dhe FEA	Shperndarja e materialeve promovuese ne rrjete sociale,		
9	FEA- DEPZHR	Kontakte me keshilluesit e karrieres se shume gjimnazeve ne tirane dhe rrethe, shperndarje direkt tek gjimnazistet postera promovues te FEA.	Shperndarja e materialeve promovuese nepermjet Whatsapp		
10	FEA- DEPZHR	Panairi i bujqesise 23 -25 Prrill 2025			
11	FEA-DMTR	Intervista	https://www.youtube.com/watch?v=E5B1RYLHxuk	Youtube	Intervista me ekspertin
12	FEA-DMTR	Intervista	https://www.youtube.com/watch?v=ADNjxtzmPOE	Youtube	Intervista me ekspertin
13	FEA-DMTR	Intervista	https://www.youtube.com/watch?v=3ftBGNiowuw&t=192s	Youtube	Intervista me ekspertin
14	FEA-DMTR	Intervista	https://www.youtube.com/watch?v=XQSRpMOKAWs	Youtube	Intervista me ekspertin
15	FEA-DMTR	Intervista	https://www.youtube.com/watch?v=MUHvUNXtkgY	Youtube	Intervista me ekspertin
16	FEA-DMTR	Postim	https://www.instagram.com/nilasulaj	Instagram	Mobiliteti si Visiting Professor
17	FEA- DMI	Identifikimi i shkollave të mesme të synuara (që zgjedhin profilet e studimit të ofruara në DMI) dhe planifikimi i vizitave informuese			
18	FEA- DMI	Bashkëpunimi me stafin e Departamentit për diskutimin e ideve për aktivitetet promovuese dhe realizimin e tyre			

19	FEA- DMI	Organizimi i një takimi me drejtuesit dhe mësuesit e këshillimit të karrierës së shkollave të mesme			
20	FEA- DMI	Pjesëmarrje në panairin e karrierës (Aktivitet i përvitshëm)			
21	FEA- DMI	Krijimi i materialeve për promovimin e programeve të studimit që ofrohen nga DMI			
22	FEA- DMI	Përdorimi i mediave sociale për promovimin e programeve të studimit të DMI			
23	FEA- DMI	Ftesë maturanëve për të vizituar kampusin e UBT/FEA			
24	FEA- DMI	Video promovuese të programeve të studimit të DMI nga studentët e saj.			
25	FEA- DDA	Promovim Prof. Dr. Ilir Kapaj	Intervsite ne TV scan		Intervsite ne media per promovimin e ofertes akademike te UBT
26	FEA- DDA	Promovim Prof. Dr. Ilir Kapaj	Intervsite ne TV klan		Intervsite ne media per promovimin e ofertes akademike te UBT dhe skema e mbeshtetjes ne Bujqesi
27	FEA- DDA	Promovim Prof. Dr. Ilir Kapaj	Intervsite ne Ora News		Promovim i programeve te studimit te UBT-se
28	FEA- DDA	Promovim Prof. Dr. Ilir Kapaj	Interviste ne Report TV		Ecuria e regjistrimeve ne programet Bachelor te UBT-se dhe çeshtje te arsimit te larte ne Shqiperi
29	FEA- DDA	Promovim		LinkedIn: Pranvera Troka	Promovim përmes rrjeteve sociale dhe kontakteve, për programet e studimit të UBT/FEA-së.

30	FEA- DDA	Promovim	Panairi 'Work & Study' (Tirane)	Po	Promovimi i Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit mbi programet e studimit që ofrohen.
31	FEA- DDA	Promovim përmes rrjeteve sociale, kontakteve dhe aktiviteteve të ndryshme, për programet e studimit të DDA, FEA dhe UBT-së.	n/a	Linkedin, WhatsApp, etj.	Promovim përmes rrjeteve sociale dhe kontakteve, për programet e studimit të UBT/FEA-së.
32	FEA- DDA	Angazhim për regjistrimet e studenteve në programet e DDA/FEA-s, për vitin akademik 2025-2026	UBT	Prane ZSS/FEA	Procesi i regjistrimeve të reja për vitin akademik 2025-2026
33	FEA- DDA	Diseminimi i rezultateve të projektit “Sfidat për një sektor ushqimor të qëndrueshëm me fokus humbjet dhe mbetjet e ushqimit” Tiranë, 30 Qershor 2025	UBT	-	Aktiviteti u promovua dhe u publikua në faqen zyrtare të Facebook-ut të universitetit.

Takime promovuese u zhvilluan edhe me studentet në prag të diplomimit e ciklit bachelor të FEA. Studentët u prezantuan me mundësitë e shkëmbimeve me universitetet më të mira nëpërmjet programeve Erasmus +, COST, INTERREG, Horizont 2020, CEEPUS, etj, dhe marrëveshjet të bashkëpunimit me institucione prestigjioze ndërkombëtare. Ata u ftuan të vazhdojnë rrugëtimin e tyre në programet e ciklit të dytë të studimeve në FEA dhe me mundësinë e përfitimit të diplomave duale me Universitetin Tuscia, Yiterbo, Itali.

5.3 FAKULTETI MJEKËSISË VETERINARE

Daljet në media kanë pësuar një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin e shkuar dhe vërehet një rritje e personelit akademik nga të gjithë departamentet fakultetit që kanë dalë si në televizionet kombëtare dhe në ato lokale për të informuar publikun e gjerë. Daljet në media dhe intervistat janë fokusuar në diskutimin e probelamtikave dhe çështje të caktuara, si epidemitë e gripit të shpendëve, Murtaja e derrave, Lija e majmunit, Siguria ushqimore dhe sëmundjet zoonotike. Në të njëjtën kohë në daljet në media është realizuar dhe promovimi i programit të specializimit afatgjatë në fushën e “Sigurisë ushqimore dhe Shëndetit Publikë” që u hap për herë të parë në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare. Këto dalje janë një mënyrë e mirë për të informuar publikun e gjerë probleamtikat e vërejtura dhe synojnë rritjen e imazhit të institucionit. Informacioni i hollësishëm mbi kolegët që kanë dalë në media dhe tematikat e diskutura i gjejmë në Tabelën 15 e mëposhme.

Nr.	Fakulteti	Lloji i aktiviteteve, takimeve promovuese	Promovim mediatik, intervista, dalje ne media	Rrjete sociale (Instagram/Facebook)	Komente
1.	Mjekësisë Veterinare	Informim mbi gripin e shpendëve	Dr. Kujtim Mersini – Fax News Link	Po	Temë epidemiologjike, informacion për publikun
2.	Mjekësisë Veterinare	Informim mbi murtajën afrikane të derrave	Dr. Kujtim Mersini – Ora News Link	Po	Fokus te sëmundjet emergjente
3.	Mjekësisë Veterinare	Informim mbi gripin e shpendëve	Dr. Kujtim Mersini – Euro News Link	Po	Përforcim i prezencës ndërkombëtare
4.	Mjekësisë Veterinare	Informim mbi gripin e shpendëve	Dr. Kujtim Mersini – Scan TV Link	Po	Fokus lokal
5.	Mjekësisë Veterinare	Informim mbi gripin e shpendëve	Prof. Asoc. Tana Kika – Ora News, Emisioni Alert Link	Po	Edukim dhe informim për publikun
6.	Mjekësisë Veterinare	Rëndësia e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimi i fermave bujqësore	Prof. Asoc. Tana Kika – Top Channel Link	Po	Promovim i politikave dhe praktikave të fermave
7.	Mjekësisë Veterinare	Mirëqenia e kafshëve për ushqim të sigurt	Prof. Asoc. Dritan Laci – Ora News, Emisioni Alert Link	Po	Siguria ushqimore dhe mirëqenia e kafshëve
8.	Mjekësisë Veterinare	Siguria ushqimore	Prof. Asoc. Dritan Laci – RTSH Link	Po	Edukim publik dhe rritje e imazhit institucional
9.	Mjekësisë Veterinare	Studimet dhe orientimi i karrierës për studentët	Prof. Asoc. Dritan Laci – Ora News, Emisioni Alert Link	Po	Edukim dhe orientim karriere
10.	Mjekësisë Veterinare	Gripi i shpendëve	Prof. Dr. Xhelil Koleci – Top Channel Link	Po	Prezencë mediatike e shpeshtë
11.	Mjekësisë Veterinare	Gripi i shpendëve	Prof. Dr. Xhelil Koleci – Klan TV Link	Po	Përforcim i informacionit epidemiologjik
12.	Mjekësisë Veterinare	Bruceloza	Prof. Dr. Xhelil Koleci – RTSH Link	Po	Fokus te sëmundjet zoonotike
13.	Mjekësisë Veterinare	Sëmundjet infektive	Prof. Dr. Xhelil Koleci – Syri TV Link	Po	Edukim dhe informim publik
14.	Mjekësisë Veterinare	Bletët dhe patologjitë e bletëve	Prof. Asoc. Kastriot Korro – Ora News, Emisioni Alert Link	Po	Fokus te sektorët e apitur dhe siguria ushqimore
15.	Mjekësisë Veterinare	Bletët dhe patologjitë e bletëve	Prof. Asoc. Kastriot Korro – TVSH Link	Po	Përfaqësim i vazhdueshëm në media lokale

Tabelat 15. Tematikat dhe aktivitetet promovuese FMV

Të dhënat e tabelës tregojnë një aktivitet të dukshëm të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare në media, ku një grup ekspertësh dhe profesionistësh të fushës përfaqësojnë rregullisht institucionin në televizione kombëtare dhe kanale të specializuara. Temat e trajtuara fokusohen kryesisht te sëmundjet infektive të kafshëve (si gripi i shpendëve, murtaja afrikane e derrave, bruceloza), siguria ushqimore, mirëqenia e kafshëve, identifikimi dhe regjistrimi i fermave, si dhe patologjitë

e bletëve, duke reflektuar drejtpërdrejt fushat kryesore të ekspertizës së fakultetit dhe rëndësinë e tyre për shëndetin publik dhe sektorin agro-ushqimor.

Përfaqësimi në emisione informative dhe formate debati, si ato mbi sigurinë ushqimore, mirëqenien e kafshëve dhe orientimin e karrierës për studentët, tregojnë se fakulteti luan një rol aktiv në edukimin e publikut dhe në komunikimin e riskut. Megjithatë, fakti që shumica e daljeve mediatike janë të përqendruara te pak profesionistë sugjeron nevojën për të zgjeruar bazën e ekspertëve që flasin në emër të institucionit, në mënyrë që të rritet diversiteti tematik dhe të përfshihen më gjerësisht të gjitha departamentet dhe fushat e specializimit brenda fakultetit.

5.4 FAKULTETI BIOTEKNOLOGJISË DHE USHQIMIT

Tabela nr. 16 ofron një pasqyrë të detajuar mbi aktivitetet promovuese dhe takimet informuese të Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit (FBU), duke përfshirë çdo departament të përfshirë: DTAU, DSHUB dhe DK. Aktivitetet përfshijnë ndërveprime direkte me institucionet arsimore, dalje mediatike, përdorim të rrjeteve sociale dhe pjesëmarrje në evente promovuese.

Nga të dhënat e tabelës evidentohen pikat kryesore:

Llojet e aktiviteteve dhe takimeve promovuese: vizita në shkolla të mesme dhe takime me maturantë të profileve profesionale dhe të përgjithshme (p.sh., shkolla "Ibrahim Rugova", "Hoteleri-Turizëm", Shkodër); takime promovuese për programet e studimit (Bachelor dhe Master) dhe prezantime në evente si "Dita e Verës"; intervistat mediatike dhe daljet në rrjetet sociale (Facebook, Instagram, LinkedIn) për të rritur ndërgjegjësimin dhe vizibilitetin e fakultetit.

Numri i daljeve në media dhe temat kryesore: intervista televizive dhe online mbi studimet e ushqimit dhe industrializimin e sistemit ushqimor; promovimi i projektit READ: Nutrition Research Synergies dhe ndikimi i konsumit të ushqimeve të përpunuara në shëndetin publik; daljet mediatike kanë pasur si qëllim prezantimin e programeve akademike dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi shkencën dhe orientimin karrierës.

Angazhimi i stafit dhe i studentëve: të gjithë anëtarët e departamenteve kanë qenë aktivë në takimet promovuese, intervistat mediatike dhe promovimin në rrjetet sociale; stafi ka kontribuar në organizimin e vizitave në shkolla dhe në zhvillimin e materialeve promovuese, duke përfshirë video dhe prezantime të drejtpërdrejta.

Pjesëmarrja në panaire dhe evente: pjesëmarrje në panaire arsimore dhe promovuese për të prezantuar programet Bachelor dhe Master; prezantime në evente të temave shkencore dhe hulumtuese, si "Dita e Verës", duke përfshirë temat mbi industrializimin, urbanizimin dhe ndikimin në shëndetin publik.

Vlerësimi i angazhimit: aktivitetet e dokumentuara tregojnë një angazhim të konsoliduar të stafit, si dhe pjesëmarrje aktive të studentëve në takime promovuese dhe në përgatitjen e materialeve mediatike; strategjia e kombinuar e komunikimit fizik (vizita dhe takime) dhe digjital (rrjetet sociale dhe media) tregojnë efikasitet në rritjen e vizibilitetit dhe promovimin e ofertës akademike. Ndërveprimet në rrjetet sociale janë të pranishme dhe të shpeshta, por nuk ka informacion të detajuar mbi analizën e impaktit të secilit postim apo aktivitet në rrjet.

Tabela nr. 16: Llojet e aktiviteteve, takimeve promovuese për FBU gjatë 2024-2025

<i>Llojet e aktiviteteve, takimeve promovuese për FBU.</i>					
Nr.	Fakulteti/ Departamenti	Lloji i aktiviteteve, takimeve promovuese	Promovim mediatik, intervista,	Rrjete sociale (Instagram/ Facebook)	Komente

			dalje në media		
1	FBU/DTAU	Takim me maturantët e shkollës "Ibrahim Rugova"	Vizitë në shkollë	Status në FB	
2	FBU/DTAU	Takim me maturantët e shkollës "Hoteleri-Turizëm", Tiranë	Vizitë në shkollë	Status në FB	
3	FBU/DTAU	Takime në Shkollën e Mesme Profesionale "Hamdi Bushati", Shkodër	Vizitë në shkollë	Status në FB	
4	FBU/DTAU	Takime në Shkollën e Mesme Profesionale "Ndre Mjeda", Bushat, Shkodër	Vizitë në shkollë	Status në FB	
5	FBU/DTAU	Takim promovues me nxënës të shkollave të mesme profesionale (në Tiranë, Golem, Durrës)	Vizitë në shkollë	Video të shkurtra të promovuara nga UBT/FBU në profilin social individual	
6	FBU/DTAU		Intervistë mbi sezonin e ri të vajit të ullirit	YouTube)	(https://www.youtube.com/watch?v=dhariRg8MQA&t=1626s)
7	FBU/DSHUB	Komunikimi Shkencor në Ditën e Verës: prezantimi i gjetjeve mbi industrializimin dhe urbanizimin e sistemit ushqimor të Tiranës; roli i grave; ndikimi i konsumit të UPF në shëndetin publik	Intervista në media mbi ndikimin e grave në sistemin ushqimor dhe rezultatet e studimit	LinkedIn	Rrit ndërgjegjësimin dhe lidh shkencën me publikun
8	FBU/DSHUB	Promovim i projektit READ: Nutrition Research Synergies; Advancing collaborative efforts for enhanced nutrition and health in Albania	Intervista në media mbi studimin në terren, problematikat e hasura gjatë studimit dhe disa prej rezultateve paraprake	LinkedIn, Instagram, TV	Rrit vizibilitetin dhe ndërgjegjëson mbi rëndësinë e studimeve të kësaj natyre në popullatën shqiptare
9	FBU/DK	Takime promovuese për programet e studimit në FBU/UBT		Promovimi i programeve të studimit Bachelor UBT/FBU	Të gjithë anëtarët e Departamentit të Kimisë kanë qenë aktivë në promovimin e programeve të studimit të

					UBT dhe Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit në rrjetet sociale, si dhe në takimet promovuese të organizuara
10	FBU/DK	Takime promovuese për programet e studimit në FBU/UBT		Promovimi i programeve të studimit të ciklit të dytë Master FBU	

Konkluzione:

Të gjithë departamentet e FBU-së (DTAU, DSHUB dhe DK) kanë kontribuar në takimet promovuese, vizitat në shkolla dhe promovimin e programeve akademike në rrjetet sociale. Stafi ka qenë aktiv në organizimin e aktiviteteve dhe komunikimin me nxënësit dhe publikun e gjerë. FBU ka kombinuar ndërveprimet direkte (vizita në shkolla, takime promovuese) me komunikimin digjital (Facebook, Instagram, LinkedIn, YouTube), duke siguruar një qasje të shumëanshme për të rritur vizibilitetin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi ofertën akademike dhe aktivitetet shkencore.

Aktivitetet tregojnë një fokus të fortë në orientimin profesional të nxënësve të shkollave të mesme dhe lidhjen me institucione arsimore parauniversitare, duke forcuar rrjetin e bashkëpunimit dhe mundësitë e rekrutimit të studentëve. Daljet në media, intervistat dhe promovimi i projekteve si kanë rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e shkencës dhe studimeve në shkencat e ushqimit dhe bioteknologjisë.

Rekomandohet:

Hartimi i një udhëzuesi të përbashkët për promovimin akademik dhe komunikimin në media dhe rrjete sociale do të ndihmonte në koordinimin e aktiviteteve dhe rritjen e efikasitetit të tyre. Rekomandohet monitorimi sistematik i të dhënave nga rrjetet sociale (reach, engagement, views) dhe analizimi i suksesit apo impaktit të secilit postim apo aktivitet në rrjet, si dhe për të optimizuar strategjinë e komunikimit.

Tabela 17. Aktivitetet ne emisione dhe dalje në mediat audiovizive gjatë vitit akademik 2024-2025

Stafi akademik	Media vizive	Tema	Link adresa në internet
K. Sulaj	Ora News	Siguria Ushqimore	https://www.youtube.com/watch?v=2CmQs6m1OHg
K. Sulaj	Klan	Mishi dhe siguria e tij	https://www.youtube.com/shorts/kYCBMF6_8iU
K. Sulaj	Top Chanell	Siguria Ushqimore sipas ligjeve të BE	https://www.youtube.com/watch?v=KURhLRFBQHc
K. Sulaj	Klan Opinion	Siguria Ushqimore Rreziku i pesticideve	https://tvklan.al/opinion-alarm-sa-te-rrezikshme-jane-prodhimet-shqiptare-10-shtator-2025
K. Sulaj	Ora News Emisioni Alert	Siguria Ushqimore Qumeshti dhe nëproduktet e tij	https://www.oranews.tv/vendi/qumeshti-i-rruges-sulaj-shifrat-e-testeve-tregojne-shifra-me-te-ultra-te-ge-i1274668
I. Lloha	Ora News Emisioni Alert	Ilaci për diabetikët	https://www.facebook.com/Ora.News.RTV/posts/ilir-lloha-paralajm%C3%ABron-ila%C3%A7i-p%C3%ABr-diabetik%C3%ABt-mund-t%C3%AB

			shkaktoj%C3%AB-dob%C3%ABsim-t%C3%AB-rrezik/908599771447571/
I. Lloha	Ora News Emisioni Alert	Alkoli ndër helmet me të rrezikshme të organizmit tonë	https://www.oranews.tv/vendi/lloha-alkooli-nder-helmet-kryesore-qe-futet-ne-organizimin-tone-eshte-i-de-i1213929

5.5 FAKULTETI SHKENCAVE PYJORE

Gjatë vitit akademik 2024÷2025, Fakulteti i Shkencave Pyjore ka qenë organizator ose pjesëmarrës aktiv në tre aktivitete promovuese të rëndësishme, të cilat lidhen drejtpërdrejt me sektorin pyjor dhe fushën didaktike. Përveç këtyre nismave, Dekani i Fakultetit ka dhënë edhe një intervistë në media, me qëllim promovimin e programeve të studimit dhe informimin e maturantëve në kuadër të procesit të regjistrimeve në arsimin e lartë.

Televizioni Kombëtar RTSH transmetoi në Mars 2025 një episod të posaçëm të emisionit “Auditor Arsimit”, i dedikuar bashkëpunimit akademik mes Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) dhe Universitetit BOKU të Vjenës. Emisioni trajtoi në mënyrë të thelluar procesin e reformimit të kurrikulave mësimore, duke nxjerrë në pah rëndësinë e kësaj reforme për forcimin e standardeve cilësore të mësimdhënies dhe përshtatjen e tyre me parimet bashkëkohore të zhvillimit të qëndrueshëm.

Gjatë diskutimit u analizuan përfitimet konkrete që sjell harmonizimi me praktikën më të mira europiane, ndikimi i inovacionit pedagogjik në përgatitjen profesionale të studentëve, si dhe roli që partneritetet ndërkombëtare kanë në rritjen e cilësisë akademike dhe kërkimore.

Ndër të ftuarit e intervistuar ishte edhe Dekani i Fakultetit të Shkencave Pyjore, Prof. Elvin Toromani, i cili solli perspektivën e Fakultetit mbi zhvillimet e fundit, theksoi domosdoshmërinë e modernizimit të kurrikulave dhe ndau përvojat nga bashkëpunimi afatgjatë me institucionet homologe europiane. Kontributi i tij u vlerësua si një dëshmi e angazhimit aktiv të fakultetit në orientimin e arsimit të lartë drejt standardeve më të avancuara të cilësisë dhe qëndrueshmërisë.

Fakulteti i Shkencave Pyjore mori pjesë në panairin “Eork and Study” të organizuar në qytetin e Gramshit, ku prezantoi programet e studimit, mundësitë akademike dhe perspektivat e punësimit që ofron fusha e shkencave pyjore. Përfaqësuesit e Fakultetit zhvilluan takime me maturantë, mësues dhe përfaqësues të institucioneve vendore, duke ofruar informacion të detajuar mbi profilin e studimeve, praktikën profesionale, kërkesat e tregut të punës dhe rolin e rëndësishëm të profesionistëve të pyjeve në menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore. Pjesëmarrja në këtë panair shërbeu si një mundësi e vlefshme promovuese për të afruar të rinjtë me profesionet e gjelbra dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e arsimit pyjor në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Në Fakultetin e Shkencave Pyjore u zhvillua ceremonia e inaugurimit të librit “Pyjet e Shqipërisë”, një përmbledhje artikujsh të botuar fillimisht në rubrikën “Kurora e Gjelbër”. Ky aktivitet shërbeu si një moment i rëndësishëm reflektimi dhe vlerësimi mbi kontributin e këtij botimi në pasqyrimin e gjendjes, sfidave dhe potencialeve të pyjeve shqiptare. Autorë, studiues dhe pedagogë diskutuan rëndësinë e librit si një burim i vlefshëm informacioni për studentët, profesionistët e fushës dhe publikun e gjerë, duke theksuar rolin e tij në ndërgjegjësimin mjedisor dhe promovimin e menaxhimit të qëndrueshëm të ekosistemeve pyjore në vend. Inaugurimi u prit me interes të gjerë dhe u vlerësua si një nismë që forcon lidhjen midis akademisë, kërkimit shkencor dhe komunitetit. Në Fakultetin e Shkencave Pyjore u zhvillua aktiviteti promovues i librit “Pyjet dhe Sharrat e Pukës në vite”, një botim me rëndësi historike e profesionale që dokumenton zhvillimet, sfidat dhe traditën e gjatë të pyjeve pukjane. Ngjarja u pasurua me pjesëmarrjen e inxhinierëve të vjetër të

pyjeve, të cilët ndanë përvoja të vyera nga dekada pune në terren, duke sjellë dëshmi të drejtpërdrejta mbi mënyrën e menaxhimit të resurseve pyjore në periudha të ndryshme. Studentë, pedagogë dhe profesionistë të fushës patën mundësinë të përfitojnë nga këto kujtime dhe reflektime, duke e shndërruar aktivitetin në një urë të çmuar midis brezave dhe në një moment të rëndësishëm vlerësimi për historinë e pyjeve dhe kontributin e specialistëve shqiptarë.

Tabela 18. Llojet e aktiviteteve, takimeve promovuese në Fakultetin e Shkencave Pyjore

Lloji i aktiviteteve, takimeve promovuese	Promovim mediatik, intervista, dalje ne media	Rrjete sociale (Inst./Fcb)	Komente
Panairi Work And Study, Gramsh			
	Intervistë në Auditor Arsimi, Dekani i FSHP-së, Maj 2025 https://youtu.be/JhghNPIUf2Y?si=6ZqG1i2yLckQgZ3K		
Inagurimit të librit “Pyjet e Shqipërisë”, një përmbledhje artikujsh nga “Kurora e Gjelbër”			Promovim Libri me pjesmarrjen e inxhinerëve të vjeter të Pyjeve
Promovimi i librit “Pyjet dhe Sharrat e Pukës në vite”			

Në krahasim me vitin e kaluar gjatë të cilit janë realizuar 4 dalje në televizione të ndryshme, kombëtare ose jo, këtë vit ka patur vetëm një të tillë, pra kemi një rënie me 75%. Pjesmarrjet në panairot Eork and Study kanë qenë në të njëjtin nivel me vitin e kaluar. Referuar aktiviteteve promovuese këtë vit kemi patur 2 të tilla, një risi, po të kemi parasysh që vitin e kaluar nuk kemi patur asnjë të tillë.

5.6 INSTITUTI I RESURSEVE GJENETIKE TË BIMËVE

Llojet e aktiviteteve, takimeve promovuese për IRGJB-n					
Nr.	Fakulteti	Loji i aktiviteteve, takimeve promovuese	Promovim mediatic, intervista, dalje ne media	Rrjete sociale (Instagram/Facebook)	Komente
1	Insituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve	Study Tour në Zvicër, si pjesë e projektit "Farat Autoktone", organizuar nga GIZ		Pasqyruar në FCB dhe Instagram/1-5.12.2024	V. Hobdari; N.Lila
2	Insituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve		Intervistë për emisionin "Ekonomia 3D" - "Rëndësia e Bankës së Farave Autoktone", IRGJB/Scan TV	Pasqyruar në FCB dhe Instagram/29.03.2025	V. Hobdari; A. Cakalli
3	Insituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve	Takim promovues në Tulla Culture Center		Pasqyruar në FCB dhe Instagram/21.03.2025	V. Hobdari; Z.Gjeta, H.Kuci
4	Insituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve	Aktivitet fushor në bazën eksperimentale të Institutit të Misrit, Shkodër		Pasqyruar në FCB dhe Instagram/02.04.2025	V. Hobdari; B.Pepa, H.Kuci
5	Insituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve	Pjesëmarrje në Panairin Ndërkombëtar të Bujqësisë -Ditët e Bujqësisë 2025, në Lushnjë		Pasqyruar në FCB dhe Instagram/23-25.04.2025	N.Lila; A. Ramaj
6	Insituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve	Takim i menaxhereve të bankave gjenetike europiane, nga ECPGR dhe AEGIS, Pragë		Pasqyruar në FCB dhe Instagram/18-21.05.2025	V. Hobdari; A. Ramaj
7	Insituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve	"Ditë fushore", takim në bazën eksperimentale në Valias me pjesëmarrje të MBZHR, EShFF, AREB etj		Pasqyruar në FCB dhe Instagram/05.06.2025	IRGJB
8	Insituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve		Intervistë "Rikthim tek farat autoktone", Tv Klan News	Pasqyruar në FCB dhe Instagram/16.06.2025	V. Hobdari
9	Insituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve	Ditë e hapur në kuadër të Projektit "Farat Autoktone" për sloganin "Prodhimet tona, rrejnëjt tona", në bazën eksperimentale të IRGJB, organizuar nga GIZ		Pasqyruar në FCB dhe Instagram/24.06.2025	IRGJB
10	Insituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve	Panel mbi rëndësinë e varieteteve autoktone organizuar në zyrat e GIZ ALBANIA		Pasqyruar në FCB dhe Instagram/03.07.2025	V. Hobdari dhe pjesëmarrës stafi N. Lila, Z.Gjeta, H.Kuci
11	Insituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve		Promovim mediatic, Turi i farave autoktone shqiptare, Top Channel	Pasqyruar në FCB dhe Instagram/21.06.2025	IRGJB
12	Insituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve	Takim me profesorë dhe kërkues të Universitetit Kombëtar Kazak Al-Farabi nga Kazakistani		Pasqyruar në FCB dhe Instagram/05.09.2025	IRGJB
13	Insituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve	Në kuadër të aktivitetit mbi "Training school Assessing Acrylamide Hazards" u realizua një takim në ambientet e IRGJB me kërkues, doktorantë dhe teknolog ushqimor nga vende të ndryshme të Europës		Pasqyruar në FCB dhe Instagram/19.09.2025	IRGJB
14	Insituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve		Promovim mediatic, Intervistë nga stafi IRGJB-s në Tv ABC News "Perimet made in Albania", prezantimi Bankës Gjenetike dhe bazës eksperimentale në Valias	Pasqyruar në FCB dhe Instagram/27.09.2025	IRGJB
15	Insituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve	Pjesëmarrje në Ditën Ndërkombëtare të Ushqimit, MBZHR, IRGJB, GIZ, Agritourism Albania		Pasqyruar në FCB dhe Instagram/16.10.2025	IRGJB

Tabela 19. Promovimi dhe kordinimi i aktiviteteve te Institutcionit në platformat sociale, Facebook dhe Instagram IRGJB

Në platformën Facebook janë publikuar 87 postime nga aktivitete të ndryshme, nga Tetor 2024 - Nëntor 2025.Në platformën Instagram janë publikuar 67 postime nga aktivitete të ndryshme, në periudhën Mars - Nëntor 2025.

6. AKTIVITETE NE KUADËR TË PROJEKTEVE

6.1 FAKULTETI MJEKËSISË VETERINARE

Gjatë periudhës 2024–2025, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka zhvilluar dhe promovuar një sërë aktiviteteve shkencore të rëndësishme në kuadër të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, të financuara nga institucione si AKKSHI. Këto aktivitete përfshijnë simpoziume, sesione shkencore dhe workshope, të cilat nuk kanë shërbyer vetëm për prezantimin e rezultateve të kërkimit, por edhe për promovimin e njësive akademike, forcimin e imazhit të Fakultetit dhe informimin e publikut mbi temat kryesore shkencore.

Departamenti i Lëndëve Klinike (DLK) organizoi më 16 dhjetor 2024 një Simpozium Shkencor në kuadër të projekteve PKKZH 2023–2024. Ky aktivitet, i koordinuar nga DLK dhe i mbështetur

nga DSHPV dhe DMPK, përfshiu katër përgjegjës shkencorë dhe tetë referime. Temat trajtonin problematika me impakt të drejtpërdrejtë në shëndetin publik, si diagnostikimi dhe parandalimi i leishmaniozës, antibiotikorezistenca në zinxhirin e prodhimit të shpendëve, dinamika e ekskretimit të E. coli O157 dhe hartëzimi i habitatit të rriqnave me identifikim PCR të patogjenëve. Aktiviteti u promovua gjerësisht në kanalet e Fakultetit dhe në webin e UBT-së, duke shërbyer si një platformë për rritjen e dukshmërisë së rezultateve kërkimore dhe lidhjeve ndërdepartamentale.

Departamenti i Shëndetit Publik Veterinar (DSHPV) zhvilloi një aktivitet të dendur shkencor gjatë vitit akademik, duke reflektuar konsolidimin e profilin kërkimor dhe rol udhëheqës në One Health. Më 25 qershor 2025, DSHPV organizoi një Sesion Shkencor në bashkëpunim me DMPK dhe Departamentin e Shkencave të Kafshëve të Universitetit të Thessali-së, ku u prezantuan gjashtë referime nga kolegë, doktorantë dhe bashkëpunëtorë ndërkombëtarë. Ky aktivitet u promovua brenda dhe jashtë fakultetit, duke forcuar rrjetin ndërkombëtar të bashkëpunimeve dhe duke rritur dukshmërinë e Fakultetit në forumet shkencore rajonale dhe ndërkombëtare.

Më 18 shtator 2025, DSHPV, në bashkëpunim me organizatën READ, organizoi një workshop mbi “Metodat e testimit të mbetjeve të pesticideve dhe vlerësimin e rrezikut për shëndetin e bletës dhe shëndetin njerëzor” në sallën e re të godinës së Anatomisë në FMV. Ky workshop, i promovuar gjithashtu në web dhe rrjetet akademike, integron dimensionin ekologjik dhe atë të shëndetit publik, duke e bërë publikun akademik dhe studentët pjesëmarrës më të vetëdijshëm mbi rëndësinë e toksikologjisë mjedisore dhe sigurisë ushqimore.

Tabela 20. Aktivitete ne kuader te projekteve FMV

Nr.	Projektet	Lloji i aktivitetit të realizuar	Periudha kohore	Partnerët	Vlera Produkti /
1	PKKZH 2023–2024	Simpozium Shkencor: Diagnostikimi dhe parandalimi i leishmaniozës; Antibiotikorezistenca në zinxhirin e prodhimit të shpendëve; Dinamika e E. coli O157; Hartëzimi i habitatit të rriqnave	16 Dhjetor 2024	DSHPV, DLK, DMPK	4 koordinatorë, 8 referime
2	DSHPV / Bashkëpunim Thessaly	Sesion Shkencor: 6 referime nga kolegë dhe doktorantë të FMV dhe bashkëpunëtorë ndërkombëtarë	25 Qershor 2025	DSHPV, DMPK, University of Thessaly	Referime shkencore dhe prezantime
3	DSHPV / READ	Workshop: Metodat e testimit të mbetjeve të pesticideve dhe vlerësimi i rrezikut për shëndetin e bletës dhe njerëzor	18 Shtator 2025	DSHPV, READ	Trajnim dhe zhvillim teknik

Analiza tematike e aktiviteteve të promovuara tregon pesë shtylla kryesore të kërkimit:

- Zoonozat dhe sëmundjet infektive
- Shëndeti i gjirit dhe menaxhimi i fermave të gjedhit
- Siguria ushqimore dhe toksikologjia mjedisore
- Mirëqenia e kafshëve
- Qasja One Health dhe temat ndërdisiplinore

Të gjitha aktivitetet e zhvilluara dhe të promovuara tregojnë një profil kërkimor të konsoliduar, ndërsa dukshmëria e tyre në web, media dhe rrjetet akademike ka rritur pozicionin e Fakultetit si një njësie kërkimore moderne dhe të ndërthurur me praktikën bashkëkohore në One Health.

6.2 FAKULTETI BUJQËSISË DHE MJEDISIT

Tabela 21. Të dhëna mbi aktivitetet e realizuara në kuadër të projekteve.

<i>Të dhëna mbi aktivitetet e realizuara në kuadër të projekteve.</i>			
Nr.	Projektet	Lloji i aktivitetit të realizuar	Periudha kohore
1	Bioeconomy excellence alliance for stimulating innovative and inclusive green transition (BEAMING)	Conference on Climate Change, Economic Development, Environment and People (CCEDEP 2025)	October 29, 2025
2		Second Conference of Youth in Agriculture of Republika Srpska	September 3, 2025,
3		Third Trade Fair and International Conference Global Challenges through the Prism of Rural Development in the Sector of Agriculture and Tourism (GIRR 2025)	May 9th, 2025
4	WG3 Non-chemical weed management in Medicinal and Aromatic Plants “weedingMAPs	Workshop	23. May 2025, Koplik, Albania
5	Establishing a Geoinformation Centre for the western Balkans at the Agricultural University Tirana (01.03.2024 - 31.12.2025)	Training Course 8 – Introduction to the Model Designer and Python Console in QGIS	Dec 2 - 6, 2025
6		Training Course 7 – Introduction to Remote Sensing and Google Earth Engine	Nov 17 - 21, 2025
7		FAO Albania: Free Hybrid GIS Courses	Oct 6 - Dec 18, 2025
8		Training Course 6 – Online Maps - Design, Implementation and more	April 7 - 11, 2025
9		Training Course 5 – Spatial Analysis of Climatic Data in R	March 3 - 7, 2025
10		Training Course 4 – Visualizing and Analyzing Spatial Data in R	Feb 3 - 7, 2025
11		Summer School 2025 - “Crop-type Mapping and Area-based Monitoring using Satellite Remote Sensing”	May 11-17, 2025
12		GIS and Geospatial Techniques in Analyzing the Influence of Climate Change and Its Consequences on Hydrological and Environmental Systems	December 17, 2025 Time: 11:00 AM CET
13		Geospatial Approaches to Hydrology and Sediment Processes in a Changing Climate	October 13, 2025 Time: 11:00 AM CET

<i>Të dhëna mbi aktivitetet e realizuara në kuadër të projekteve.</i>			
Nr.	Projektet	Lloji i aktivitetit të realizuar	Periudha kohore
14		Digital Agriculture and Rural Transformation (DART): Shaping Inclusive Digital Futures in Albania's Countryside	June 25, 2025 Time: 11:00 AM CET
15		Land Use & Land Cover Analysis with GIS/RS for Conservation and Sustainable Tourism in Protected Areas	May 6, 2025 Time: 11:00 AM CET
16		Tracking Wildfire Dynamics in the Republic of Srpska, Bosnia and Herzegovina	April 1, 2025 Time: 11:00 AM CET
17		The Role of Land Mines, Ethnicity, and Geography in Explaining Land Cover Change in Bosnia and Herzegovina	Feb 11, 2025 Time: 11:00 AM CET
18		Scale-Dependent Diversity of Agricultural Land Uses in the Republic of Kosovo	Jan 15, 2025 Time: 11:00 AM CET
19		Short-Term Research Visits to IAMO	Sep. 01-26, 2025 or Oct. 06-31, 2025
20		Stakeholder workshop at ICOALS5 Conference	Nov 03 - 05, 2025

Gjatë periudhës 2024-2025, Stafi i Departamentit të Shkencave Agronomike ka marrë pjesë në një gamë të gjerë aktivitetesh profesionale, shkencore dhe trajnimi në kuadër të projekteve ndërkombëtare, veçanërisht në fushat e bioekonomisë, GIS/Remote Sensing, bujqësisë digjitale dhe menaxhimit të bimëve mjekësore.

Aktivitetet dhe konferencat ndërkombëtare

Projekti **BEAMING** ka mundësuar pjesëmarrjen në disa konferenca të rëndësishme rajonale dhe ndërkombëtare në Bosnje, Serbi etj, duke kontribuar në promovimin e bioekonomisë, zhvillimit rural dhe tranzicionit të gjelbër. Data të tilla si CCEDEP 2025, “Youth in Agriculture”, dhe “Global Challenges in Rural Development” tregojnë një angazhim të fortë akademik në temat globale të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Workshop-e dhe aktivitete kërkimore

Projekti **WeedingMAPs** ka realizuar një ëorkshop specialistësh për menaxhimin jo-kimik të barërave të këqija në bimët mjekësore në Koplik, Shqipëri, duke krijuar bashkëpunim ndërmjet prodhuesve, studiuesve dhe komunitetit.

Projekti për Qendrën e Gjeoinformacionit në Ballkanin Perëndimor (2024–2025)

Ky projekt është më aktiv dhe me numrin më të madh të veprimtarive. Gjatë vitit 2025 janë realizuar:

17 kurse trajnimi në GIS, Remote Sensing, Google Earth Engine, analizë klimatike dhe vizualizim të të dhënave.

2 shkolla verore, të dedikuara për monitorimin bujqësor me satelitë dhe administrimin gjeohapësinor të tokave bujqësore.

10 webinarë tematike mbi klimën, erozionin, përdorimin e tokës, turizmin e qëndrueshëm dhe menaxhimin e zjarreve.

Këto aktivitete kanë rritur ndjeshëm kapacitetet teknike të stafit dhe studentëve, duke e pozicionuar AUT-in si qendër rajonale kompetence në fushën e gjeoinformacionit.

Workshop-i i ICOALS5 (Nëntor 2025)

Workshop ne kuadër të ICOALS 5 “Discussion on Mountain Pastures and Shepherds in Albania: Challenges and Prospects” me përfaqësues nga UBT, Shoqata, Grassroot Institut of Canada, i organizuar Nda DSHZ .

Workshop në kuadër të projektit të AKKSHI Marrëdhëniet midis të ushqyerit dhe sëmundshmërisë nga mastitet në fermat e lopëve në vendin tonë” realizuar ne QTTB e Korçës me specialistë dhe fermerë të rajonit.

6.3 FAKULTETI BIOTEKNOLOGJISË DHE USHQIMIT

Tabela nr. 5 paraqet një panoramë gjithëpërfshirëse të aktiviteteve të realizuara në kuadër të projekteve kërkimore dhe zhvillimore në FBU gjatë periudhës 2024–2025, të cilat kanë kontribuar drejtpërdrejt në përhapjen dhe komunikimin shkencor brenda komunitetit akademik, partnerëve ndërkombëtarë dhe aktorëve të industrisë ushqimore. Këto aktivitete përbëjnë mekanizmat kryesorë për shpërndarjen e rezultateve të kërkimit, përmirësimin e dukshmërisë institucionale dhe forcimin e kulturës së shkëmbimit të njohurive.

Gjatë periudhës së raportimit janë realizuar 16 aktivitete të fokusuara në komunikim dhe përhapje, të cilat përfshijnë:

Workshop-e (10 në total) – format kyçe për transferimin e njohurive praktike dhe shkencore drejt studentëve, stafit akademik, industrisë dhe partnerëve institucionalë;

Shkolla verore dhe training schools (3 në total) – që kanë kontribuar në ndërkombëtarizimin e njohurive dhe përfshirjen e studentëve në rrjetet akademike evropiane;

Konferencë ndërkombëtare (1) – e cila ka shërbyer si platformë për diseminimin e rezultateve të avancuara kërkimore dhe bashkëpunimin ndërkombëtar;

Trajnime të specializuara prodhimi (2) – me qëllim transferimin e teknikave tradicionale dhe inovative drejt aktorëve të industrisë.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë përhapur rezultate, metodologji kërkimore dhe praktika inovative përmes prezantimeve, sesioneve demonstrative, diskutimeve të strukturuar dhe materialeve komunikimi. Lidhjet e shpërndara online (p.sh. në Instagram, website institucional, blog akademik) tregojnë se të paktën 4 aktivitete janë komunikuar publikisht me akses të hapur, duke rritur dukshmërinë e projekteve tek komuniteti i gjerë.

Tabela nr. 22: Të dhëna mbi aktivitetet e realizuara në kuadër të projekteve në FBU, për periudhën 2024–2025.

Të dhëna mbi aktivitetet e realizuara në kuadër të projekteve, FBU.				
Nr.	Fakulteti/Departamenti	Projektet	Lloji i aktivitetit të realizuar	Periodha kohore
1.	FBU/DTAU	Izolimi i mikroorganizmave patogjenë në pika kritike të kontaminimit në industrinë ushqimore për arritjen e standardeve të BE-së në sigurinë ushqimore	Projekt kërkimor në zhvillim	2025 – në vazhdim
2.	FBU/DTAU	COST Action CA21149 – Reducing acrylamide exposure of consumers by a cereals supply-chain approach targeting asparagine (ACRYRED)	Training School: Assessing Acrylamide Hazards	17–19.09.2025
3.	FBU/DTAU	COST Action IG19145 – Artificial intelligence methods for spectral data processing to solve food fraud and authenticity issues (SensAIfood)	Final International sensAIfood Conference Tirana	08–10.10.2025
4.	FBU/DTAU	Valorizimi i mbetjeve të ngurta të industrisë ushqimore dhe shfrytëzimi i tyre për bioenergji dhe produkte të dobishme (PKKZH 2024)	Workshop: Vlerësimi i mbetjeve dhe shkarkimeve të industrisë ushqimore	07.02.2025
5.	FBU/DTAU	RO-1111-10-2526 – Food Safety for Healthy Living	Shkollë Verore Food Safety for Healthy Living	23–25.09.2025
6.	FBU/DTAU	PKKZH–AKKSHI: Përdorimi i vajrave esencialë nga bimët mjekësore dhe aromatike si antimikrobikë natyrorë në ruajtjen e ushqimeve	Workshop	20.05.2025
7.	FBU/DSHUB	Nutrition Research Synergies – READ, AADF	Workshop përmbyllës	14.02.2025
8.	FBU/DSHUB	Përdorimi i vajrave esencialë si antimikrobikë natyrorë në ruajtjen e ushqimeve (PKKZH, AKKSHI)	Workshop përmbyllës	20.05.2025
9.	FBU/DSHUB	Projekt kërkimor AKKSHI – Roli socio-ekonomik i grave në zhvillimin e qëndrueshëm të sistemeve ushqimore (2023–2024)	Komunikim shkencor, aktivitete edukative, takime me aktorë të industrisë, media, leksion i hapur	03.2024 – 04.2025

10.	FBU/DK	Rëndësia e aplikimit të Indikatorëve Kohë-Temperaturë (TTI) në cilësinë e ushqimeve gjatë zinxhirit ftohës	Workshop I – Paketimi dhe zinxhiri ftohës; ndikimi mjedisor i mbetjeve nga paketimet	05.2024
11.	FBU/DK	Rëndësia e aplikimit të Indikatorëve Kohë-Temperaturë (TTI) në cilësinë e ushqimeve gjatë zinxhirit ftohës	Workshop II – Paketimi aktiv vs. inteligjent dhe ndikimi mjedisor i mbetjeve plastike	05.2024
12.	FBU/DK	Rëndësia e aplikimit të Indikatorëve Kohë-Temperaturë (TTI) në cilësinë e ushqimeve gjatë zinxhirit ftohës	Workshop III – Perceptimi dhe sjellja e konsumatorit; paketimi inteligjent; dizenjimi i TTI	09.2024
13.	FBU/DK	Rëndësia e aplikimit të Indikatorëve Kohë-Temperaturë (TTI) në cilësinë e ushqimeve gjatë zinxhirit ftohës	Workshop IV – Paraqitja e rezultateve të projektit	05.2025
14.	FBU/DK	Prospettive di Filiere casearie ad ImpaTto 0 – “PROFIT 0”	Workshop: Prezantimi i projektit dhe aktiviteteve të planifikuara	Shkurt 2025: https://www.instagram.com/p/DFtHxzPtat/?igsh=MWQzNW4xcWZ3YWtobg==
15.	FBU/DK & DTAU	Prospettive di Filiere casearie ad ImpaTto 0 – “PROFIT 0”	Workshop Importance of Traditional Food Products Certification	09/ 2025: https://ubt.edu.al/en/blog/universiteti-1/trajnim-dhe-workshop-mbi-prodhimin-e-mocareles-dhe-gjizes-ne-ubt-ne-bashkepunim-me-artizane-italiane-te-gioia-del-colle-84
16.	FBU/DK	PROspettive di Filiere casearie ad ImpaTto 0 – “PROFIT 0”	Trajnim për prodhimin e mocarelës (studentë, teknikë, specialistë, grupe interesi)	09/ 2025: https://www.instagram.com/reel/DPTBYcVDEtI/?igsh=MW9lYXR3aXZzbXcxBA==

Konkluzion:

Në tërësi, aktivitetet e dokumentuara (workshop-e, shkolla verore, training school, konferenca ndërkombëtare dhe trajnime praktike) për projektet demonstrojnë një angazhim të konsoliduar të FBU-së për përhapjen e njohurive, forcimin e komunikimit shkencor dhe integrimin e komunitetit akademik në rrjete bashkëpunimi kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Këto aktivitete kanë rritur impaktin e projekteve, përmirësuar imazhin institucional dhe mbështetur transferimin e njohurive drejt studentëve, aktorëve të industrisë dhe publikut të gjerë.

Aktivitetet kanë kontribuar gjithashtu në integrimin e rezultateve kërkimore në leksione, seminare dhe ushtrime laboratorike, duke përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Për më tepër, materialet e diseminimit (prezantime, workshop-e, blogje, rrjete sociale) kanë rritur aksesin e publikut dhe kanë forcuar transparencën e projekteve.

Rekomandohet:

Shtimi i workshop-eve dhe shkollave trajnimi mund të rrisë pjesëmarrjen e studentëve dhe partnerëve të rinj ndërkombëtarë.

Publikimi sistematik i materialeve, prezantimeve dhe rezultateve në një portal institucional ose rrjete sociale do të rrisë impaktin dhe qasjen për audienca të ndryshme.

Krijimi i një plani të qartë për shpërndarjen e njohurive dhe komunikimin e projekteve në fillim të çdo projekti kërkimor do të sigurojë përfitim maksimal për fakultetin dhe komunitetin akademik.

6.4 FAKULTETI SHKENCAVE PYJORE

Gjatë vitit akademik 2024÷2025, Fakulteti i Shkencave Pyjore ka zhvilluar ose ka qenë pjesëmarrës aktiv në pesë aktivitete profesionale (ëorkshops), të organizuara në kuadër të projekteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këto iniciativa, anëtarë të stafit akademik të Fakultetit kanë marrë pjesë si pjesëtarë të ekipeve kërkimore ose si koordinatorë, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e objektivave të projekteve dhe në rritjen e kapaciteteve profesionale të institucionit.

Në kuadër të projektit Regional Forest Biodiversity, Departamenti i Pyjeve mori pjesë në Ëorkshop-in Rajonal për Biodiversitetin Pyjor, një aktivitet që mbledhi së bashku, në Goc të Serbisë, ekspertë, studiues dhe përfaqësues institucionalë nga vendet e rajonit. Gjatë punimeve u diskutuan sfidat dhe prioritetet kryesore për ruajtjen e biodiversitetit pyjor, qasjet moderne për monitorimin e ekosistemeve dhe rëndësia e bashkëpunimit ndërkufitar në menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore. Pjesëmarrësit ndanë përvoja, të dhëna dhe praktika të mira, duke e kthyer ëorkshop-in në një platformë të vlefshme shkëmbimi profesional dhe forcimi të partneriteteve rajonale në fushën e ekologjisë pyjore.

Në kuadër të projektit të financuar nga AKKSHI “Vetitë teknologjike të drurit të trajtuar termikisht dhe ndikimi në mjedis”, Departamenti i Industrisë së Drurit organizoi një ëorkshop dedikuar analizimit të teknologjive bashkëkohore të trajtimit termik të drurit dhe ndikimit të tyre në karakteristikat fiziko–mekanike të materialit. Gjatë aktivitetit, studiues dhe profesionistë të fushës prezantuan rezultate kërkimore, diskutuan avantazhet dhe kufizimet e trajtimit termik, si dhe implikimet e tij mjedisore në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm. Ëorkshop-i u shndërrua në një hapësirë të vlefshme shkëmbimi njohurish dhe përvojash me sektorin prodhues, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve akademike dhe profesionale në përpunimin dhe përdorimin e drurit të modifikuar termikisht.

Në kuadër të projektit “Women in Climate Action – The Montreal Protocol & Gender Equality”, anëtarë të Departamentit të Fizikës dhe Shkencave të Aplikuara morën pjesë në një ëorkshop ndërgjegjësues që theksoi rolin e grave në veprimet kundër ndryshimeve klimatike dhe rëndësinë e Protokollit të Montrealit në mbrojtjen e shtresës së ozonit. Gjatë aktivitetit u diskutua kontributi i grave në fushën e mjedisit, sfidat me të cilat ato përballen dhe mundësitë për fuqizim të mëtejshëm përmes edukimit, politikave të barazisë gjinore dhe angazhimit në vendimmarrje. Ëorkshop-i shërbeu si një platformë motivuese për promovimin e pjesëmarrjes aktive të grave në ndërtimin e një të ardhmeje të qëndrueshme.

Në Fakultetin e Shkencave Pyjore u mbajt një prezantim i dedikuar projektit mbi dëmtuesin e pishës së butë (*Pinus pinea L.*), të njohur si “Breshkëza e pishës” (*Toumeyella parvicornis*), i zhvilluar nga Dr. Giuseppino Sabbatini. Gjatë sesionit, Dr. Sabbatini paraqiti të dhëna shkencore mbi biologjinë, përhapjen dhe ndikimin e këtij insekti invaziv në ekosistemet pyjore mesdhetare, duke theksuar rrezikun që ai paraqet për pyjet shqiptare. Prezantimi solli rekomandime për

monitorimin, menaxhimin dhe zbutjen e dëmeve, duke ofruar një kontribut të vlefshëm për rritjen e ndërgjegjësimit dhe forcimin e kapaciteteve profesionale në fushën e mbrojtjes së pyjeve.

Në Janar të 2025, në Fakultetin e Shkencave Pyjore u organizua event i hapës i projektit “Krijimi i një modeli menaxhimi për luftimin e dëmtuesit të procesionares së pishës”, një nismë me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e ekosistemeve pyjore. Aktiviteti u nderua me pjesëmarrjen e Rektorit të UBT-së, si dhe të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Pyjore, të cilët theksuan rëndësinë e projektit për zhvillimin e një strategjie të qëndrueshme dhe shkencërisht të bazuar në trajtimin e këtij dëmtuesi problematik. Event i shërbeu si një platformë për prezantimin e objektivave kryesore, metodologjisë së projektit dhe rëndësinë e bashkëpunimit institucional në mbrojtjen e pyjeve shqiptare.

Tabela 23. Të dhëna mbi aktivitetet e realizuara në kuadër të projekteve.

Nr.	Projekti	Lloji i aktivitetit të realizuar	Periudha kohore
1	Regional Forest Biodiversity	Workshop Rajonal për Biodiversitetin Pyjor /Goc, Serbi	Korrik 2025
2	Vetitë teknologjike të drurit të trajtuar termikisht dhe ndikimi në mjedis	Workshop	Korrik 2025
3	“Women in Climate Action The Montreal Protocol & Gender Equality”	Workshop	Maj 2025
4	Dëmtuesi i pishës së butë (Pinus pinea L) “Breshkëza e pishës” (Toumeyella parvicornis)	Dr. Giuseppino Sabbatini, studiues Etomolog, CREA, Itali	Shkurt 2025
5	Krijimi i një modeli menaxhimi për luftimin e dëmtuesit të procesionares së pishës	Eventi hapës i projektit me pjesëmarrjen e Dekanit të FSHP-së dhe Rektorit të UBT-së	Janar 2025

Duke mos patur referenca bazuar në Raportin e vitit të kaluar, nuk mund të japim asnjë vlerë krahasuese

6.5 INSTITUTI I RESURSEVE GJENETIKE TË BIMËVE

Të dhëna mbi aktivitetet e realizuara në kuadër të projekteve, IRGJB				
Nr.	Projektet	Lloji i aktivitetit të realizuar	Periudha kohore	
1	Projekti “Farat autoktone” GIZ Sustainable Development of Rural Areas (SRD) PN (number) 21.2315.6-006.00	1. Monitorimi dhe Vlerësimi i ecures së projektit nëpërmjet ekspertizës te fermeri	Dhjetor 2024- Dhjetor 2025	
		2 . Trajnime të ndryshme te agroturizmet		
		3. Ndërgjegjësimi i aktorëve të ndryshëm i vlerave të farave autoktone		
		4. Promovimi i kultivimit dhe ruajtjes së tyre		
2	“Eksplorimi, identifikimi dhe koleksionimi i mostrave të kultivarëve	1. Hulumtimi i të dhënave për zonat në studim nga literatura ekzistuese		

lokal dhe të afërme të egër të bimëve bujqësore në zonën Gramsh–Pogradec, për pasurimin e fondit në Bankën Gjenetike Kombëtare”, Miratuar me Nr. 3701 Prot., datë 18.12.2024.	2. Përgatitja e hartave topografike, organizmi i logjistikës dhe ndarja në grupe pune	Maj 2025-Dhjetor 2025	
	3. Vizita në terren për identifikimin e bimëve me interes, evidentimi i shkallës së përdorimit/shfrytëzimit të llojeve bimore		
	4. Karakterizimi i bimësisë së identifikuar		
	5. Koleksionimi i mostrave të identifikuara, përpunimi dhe dokumentimi i tyre		
	6. Përpilimi i një raporti të hollësishëm dhe publikimi i rezultateve nëpërmjet artikujve/posterave		

Tabela 24. IRGJB

7. ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI I RRJETEVE SOCIALE

Vlerësimi i rrjeteve sociale, instagram dhe facebook një vlerësim të përgjithshëm i vizibilitetit në instagram, të evidentohet me grafik për periudhën janar- maj 2024 dhe qershor- dhjetor 2024. Cilat janë aktivitetet dhe programet e studimit për të cilat është treguar më shumë interes.

të paraqitet në mënyrë përshkruese dhe grafike vizibiliteti ne facebook për periudhën janar-maj 2024 dhe qershor- dhjetor 2024.

Evidentoni target group që ka treguar më shumë interes.

Informacioni të evidentohet nëpërmjet grafikëve që përpunohen nga faqet e facebook dhe instagram-it të cdo Fakulteti.

Në këtë raport janë trajtuar në mënyrë të detajuar interaktiviteti që rrjetet sociale të Universitetit Bujqësor të Tiranës (Facebook dhe Instagram) kanë gjeneruar gjatë periudhës kohore prej 320 ditësh për Facebook (1 Janar – 16 Nëntor) dhe gjatë 90 ditëve të fundit për Instagram. Analiza përqendrohet në performancën e përmbajtjes, nivelin e angazhimit të ndjekësve, si dhe karakteristikat demografike të audiencës. Në vijim paraqiten pikat kryesore të vlerësimit:

Profilet e arritura nga postimet

Ky seksion përfshin numrin total të profileve unike që kanë parë postimet e publikuara në faqet zyrtare të universitetit. Analiza e reach-it tregon se sa efektive kanë qenë postimet në shpërndarjen e informacionit dhe në shtrirjen e komunikimit institucional. Përfshihen këtu ndryshimet në performancë përgjatë periudhës së analizuar, ndikimi i llojit të përmbajtjes (foto, video, evente, njoftime), si dhe rritja natyrale apo e ndikuar nga fushata promovimi.

Ndërveprimi nga profilet me postimet (pëlqimet, shpërndarjet, komentimet)

Në këtë pikë analizohet niveli i angazhimit që ndjekësit kanë treguar me postimet, duke përfshirë pëlqimet, komentet, shpërndarjet dhe reagimet e tjera. Këto të dhëna ndihmojnë në vlerësimin e interesit të audiencës për temat e trajtuara dhe tregojnë llojin e përmbajtjes që gjeneron më shumë ndërveprim. Ndërveprimi është një tregues i rëndësishëm i lidhjes midis institucionit dhe ndjekësve të tij.

Top 5 postimet me më shumë interaktivitet

Këtu identifikohen pesë postimet më të suksesshme në platforma, bazuar në numrin e total të reageimeve, komenteve dhe shpërndarjeve. Analiza e këtyre postimeve shërben për të kuptuar cilat

tema, evente apo forma komunikimi kanë performuar më mirë, duke ndihmuar në hartimin e strategjive të ardhshme të përmbajtjes.

Top 5 shtetet me më shumë ndjekës

Raporti paraqet një përmbledhje të pesë shteteve kryesore nga vijnë ndjekësit e faqes. Kjo ofron një pasqyrë të shtrirjes ndërkombëtare të universitetit dhe interesit të komuniteteve jashtë Shqipërisë për aktivitetet e UBT-së. Të dhënat mund të përdoren për të përmirësuar komunikimin me audiencën e huaj dhe për të zhvilluar fushata të përshtatura për grupe të caktuara.

Top 5 qytetet me më shumë ndjekës

Në këtë seksion paraqiten qytetet me përfaqësimin më të madh të ndjekësve. Të dhënat ndihmojnë në identifikimin e zonave ku universiteti ka ndikimin më të madh, si dhe në kuptimin e shpërndarjes gjeografike të audiencës brenda vendit dhe jashtë tij.

Mosha e ndjekësve

Analiza e moshës së ndjekësve jep një panoramë të qartë mbi grupmoshat më aktive që ndjekin faqet e universitetit. Këto informacione janë të rëndësishme për përshtatjen e përmbajtjes me interesat dhe nevojat e secilit segment demografik, veçanërisht të rinisë, e cila përbën grupin kryesor të synuar për komunikimin institucional.

Raporti gjinor i ndjekësve

Kjo pikë trajton shpërndarjen gjinore të audiencës në rrjetet sociale të UBT-së. Njohja e raportit midis ndjekësve meshkuj dhe femra ndihmon në ndërtimin e një strategjie komunikimi më gjithëpërfshirëse, si dhe në identifikimin e mundësive për të balancuar ose zgjeruar ndikimin tek njëra gjini.

Platforma Facebook




Figura 11. Analiza Platforma FCB

Në raportin e gjeneruar nga Facebook në lidhje me performancën për 320 ditë kemi:

1 428 124 shikime nga profile unike që kanë vizituar faqen e UBT

43 365 ndërveprime nga ndjekësit (pëlqime, shpërndarje, komente), kemi një rritje me 26% krahasuar me 1 vit më parë.

445 ndjekës të rinj ku kemi një rënje me 17% krahasuar me 1 vit më parë.

Nga grafiku vërejmë ditë e pikut dhe rënjes së interaktivitetit, vihet re një interaktivitet i shtuar gjatë periudhës së promovimit (Korrik- Shtator).




Figura 12. Interaktiviteti Facebook UBT.

Shikueshmërinë për 320 ditë e kemi:

1 428 124 shikime në total të postimeve në profilin e UBT.

Një rol të rëndësishëm zë ndarja e 3 sekondave të para të postimeve format video dhe shikimet që arrijnë për 1 minut të videos. Kemi një rritje prej 55% të shikimeve për 3 sekondat e para të videos në një total prej 104 134 shikimesh. Gjithashtu kemi dhe një rritje prej 7% për shikimet që arrijnë 1 minut të videos me një total prej 2639 shikimesh.

Nga grafiku vërejmë ditë e pikut dhe rënjes së interaktivitetit, pikun më të lartë e kemi në ditët e fushatës promovionale periudha Qershor- Shtator.




Figura 13: Top 5 postimet më të pëlqyera

Sipas të dhënave të gjeneruara vihet re se postimet të cilat kanë shfaqur më shumë interes kanë qënë postimet në lidhje me promovimin e programeve të reja dhe aktivitetëve të zhvilluara në UBT.




Figura 14. Lloji i postimeve më shumë të pëlqyera

Siç vihet re kemi një disbalancë mes profileve që janë ndjekës dhe atyre të cilët nuk e ndjekin faqen. Mesazhi që UBT dëshiron të përcjellë përçohet më mirë në formatin e shumë fotove në një postim sesa në formate të tjera si video, link, etj.


Figura 15. Shtrirja gjeografike e ndjekësve



Natyrshëm Shqipëria dhe Kosova janë shtetet me më shumë ndjekës të faqes, por vlen për tu theksuar dhe interesi ndërkombëtar.



Qytetet me më shumë interaktivitet i përkojnë gjithashtu dhe qyteteve me ardhjen më të madhe të studentëve



Raporti Femra-Meshkuj dhe mosha ndjekësve

Në platformën Facebook dominon gjinia mashkullore me një % më të lartë. Gjithashtu kryeson mosha «studentore» por vlen për tu theksuar dhe interesi nga mosha mbi 25-34 vjeç.

Account insights

Views ⓘ

931,732

Views


Followers 56.1%

Non-followers 43.9%

Accounts reached 33,527

Në raportin e gjeneruar nga Instagram në lidhje me performancën për 90 ditë kemi: 931 732 shikime ku 56.1% i kemi nga ndjekësit e faqes dhe 43.9% nga vizitor të huaj, ku nga këto


By content type




kemi 33 527 profile të arritura. Vihet re raporti I preferencave të ndjekësve midis storyve, postimeve dhe videove reels të cilët kanë një interesim më të lartë për formatin thjesht story sesa marrja e informacionit në video.

Content insights

All Views Highest




Top postimet ku kryesimin e mban Konferenca ICOALS 5 e më pas aktivitete të ndryshme të



zhvilluara në UBT .

Mosha mesatare e ndjekësve I përkon gjithashtu moshës së studentëve nga e cila kuptojmë se është një formë tepër e vlefshme komunikimi.



Qytetet me më shumë interaktivitet i përkohet gjithashtu dhe qyteteve me ardhjen më të madhe të studentëve.



Ndryshe nga platforma Facebook në Instagram kemi një nivel më të lartë të ndjekësve femra në vlerën 51.7% nga meshkujt 48.3%.



Në total profili I UBT në instagram numëron 6417 ndjekës. Krahësuar me periudhën 90 ditore të mëparshme kemi një rritje me 8.5%. Nga raporti mund të përcaktojmë dhe pikun më të lartë të ndjekësve të rinj e cila i përkon periudhës së fillimit të vitit akademik.

Rekomandime për të ardhmen

Në bazë të të dhënave të analizuara, rekomandohen hapa të rëndësishëm për përmirësimin e performancës së rrjeteve sociale, si për shembull:

- **Rritja e publikimeve vizuale**, veçanërisht video dhe përmbajtje dinamike që sjell më shumë ndërveprim.
- **Përdorimi i një kalendari të strukturuar editorial**, për të siguruar postime të rregullta dhe të organizuara.
- **Fokus tek përmbajtjet që kanë performuar më mirë**, si eventet, arritjet e studentëve dhe njoftimet me interes të gjerë.
- **Angazhimi më i madh me audiencën**, duke iu përgjigjur komenteve dhe mesazheve në kohë, për të rritur ndërveprimin organik.
- **Rritja e postimeve në gjuhë të huaj**, për të targetuar ndjekësit jashtë Shqipërisë dhe për të zgjeruar imazhin ndërkombëtar të universitetit.
- **Promovimi i fushatave të synuara**, veçanërisht në periudhat e aplikimeve dhe eventeve kryesore akademike.
- **Analizim i vazhdueshëm i performancës**, për të përshtatur strategjinë sipas prirjeve të reja dhe interesave të audiencës.

8. PERFORMANCËS SË FAQES ZYRTARE TË UNIVERSITETIT www.ubt.edu.al

Gjatë vitit raportues, faqja zyrtare e universitetit ka shënuar rritje të qëndrueshme në numër vizitorësh, përditësime dhe ndërveprime. Platforma ka shërbyer si burimi kryesor i informacionit për studentët, stafin akademik dhe publikun e gjerë, duke ofruar njoftime, evente dhe dokumente zyrtare.

Aktivitetet Kryesore të zhvilluara në web

Publikimi i mbi 177 njoftimeve sipas kategorive (Universiteti, Erasmus +, Studenti, Projekte, Archive, Vendime, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ).

Përditësimi i vazhdueshëm i dokumenteve zyrtare (transparenca, udhëzime, formularë etj...).

Krijimi i faqeve të reja për secilin program studimi/kurrikule.

Krijimi i faqeve të reja për cdo fakultetet dhe nën faqe për cdo departament.

Ngarkimi i CV-ve në format PDF për secilin pedagog si dhe ndertimi i faqes personale për cdo profil pedagogu për të siguruar informacion të detajuar mbi kualifikimet dhe përvojën e stafit akademik.

Statistikat e Trafikut

Numri total i vizitorëve gjatë vitit **325534**.

Burimet kryesore të trafikut (Google Search, rrjetet sociale)

Pajisjet më të përdorura (desktop, mobile).

Ditët më të klikuara

Nga grafiku i trafikut ditor ("Daily Views"):

- Trafiku fillon i ulët në fund të vitit 2024.
- Rritet pak në pranverën 2025.
- Arrin pikun ekstrem në korrik–shtator 2025, ku disa ditë shkojnë mbi 4000–6000 klikime në ditë.





Figura 16. Analiza e vizitoreve faqja WEB-UBT

Pas shtatorit 2025 nis një tendencë e lehtë rënijeje, por vazhdon të jetë lartë.

Ditët me pikat më të larta:


- Gusht 2025 – kulmi kryesor i trafikut
- Shtator 2025 – disa nga ditët më të klikuara të gjithë vitit



Rekomandime

- Struktura e faqeve të stafit akademik: dokumente, foto dhe CV të pa ngarkuara plotësisht. Përditësimi i disa faqeve për shembull:

Informacion qe duhet permiresuar ne menu kryesore



- Implementimi i një dizajni të unifikuar për njoftimet dhe eventet ku mungojne të dhënat për kalendarin e ardhshme.
- Menuja kryesore Kërkim Shkencor duhet plotësuar me të dhëna gjithashtu dhe disa faqe/nënfaqe kanë mungesë informacioni.
- Vendosja e SEO për linqet, me qëllim rritjen e dukshmërisë së faqeve në motorët e kërkimit dhe përmirësimin e renditjes organike.
- Vendosja e “breadcrumbs”, që lehtëson navigimin dhe përmirëson SEO.
- Shtimi i përmbajtjes multimediale (video, infografikë) për rritjen e angazhimit.
- Optimzimi i linkeve të brendshme, për të rritur kohëzgjatjen e vizitës dhe indeksimin e faqeve më pak të vizituara.

9. PERFORMANCA E QENDRES SE KARRIERES DHE ALUMNI PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2025

Pjesë e vizionit të Universitetit Bujqësor të Tiranës është edukimi universitar, pasuniversitar, kërkimi dhe trajnimi për përgatitjen profesionale të specialistëve të fushës së bujqësisë, blegtorisë, ushqimit dhe të mjedisit. Në këtë kuadër nevoja e ndërmarrjes së inicjativave që përafrojnë kapacitetet me edukimin e duhur profesional të studenteve me universitete ndërkombëtare, sipërmarrjet, organizatat dhe institucionet publike që janë të lidhura me fushën e bujqësisë, ushqimit dhe të mjedisit, është nevojë e padiskutueshme.

Qëllimi kryesor i QKA është të informojë, orientojë dhe mbështesë studentët e UBT, në funksion të paraprirjes së një karriere të suksesshme, duke krijuar mundësi për realizmin e praktikave,

trajnime të ndryshme, pjesmarrje në konferenca, workshop, seminare, dhe më e rëndësishme të lehtësojë kontaktin me tregun e punës si edhe gjurmimin e ecurisë së tyre të mëtejshme.

Performanca e Zyrave të Karrierës dhe Studentëve (ZKS)

Sikurse edhe vite më parë, përgjegjësit e ZKS, në fund të çdo 3-mujori, raportojnë pranë QKA, performancën e tyre përgjatë kësaj periudhe. Raportimi nga ana e ZKS, referohet mbi disa elementë të punës së tyre të përditshme. Këto elementë janë nxjerrë nga përshkrimi i punës tyre (*Job description*). Si rezultat, të dhënat e performancës së ZKS-ve, për vitin kalendarik 2025, pasqyohen në mënyrë të detajuar në Tabelën 3.

Tabela 25. Performanca e ZKS për vitin kalendarik 2025.

Vlerësimi sasior							
Nr	Aktivitetet e realizuar	FEA	FBM	FBU	FSHP	FMV	Total
1	Paketa i informacionit orientues	4	4	2	2	1	13
2	Numri i shkollave të Mesme ku janë zhvilluar prezantime të programeve të studimeve të UBT	81					
3	Numri i takimeve informuese ndaj studentëve të viteve të para të informuar rreth mesimit, QKA dhe ZKS	18	25	21	20	23	107
4	Numri i studentëve të shërbyer nga zyra e ZKS	97	133	89	77	105	501
5	Numri i informacioneve të shpërndara virtualisht dhe afishuara fizikisht rreth mundësive për Punësim, trajnime, Bursa studimesh, Praktika Profesionale, etj., që lidhe direkt me karrierën e studentëve	31	29	26	21	13	120
6	Numri i Bizneseve, Institucioneve Publike dhe organizatave të siguruar për pjesmarrje në Aktivitetet e UBT	13	11	7	5	10	46
7	Numri i formulareve të plotësuara lidhur me gjurmimin e studenteve të UBT	649	339	138	82	71	1279
8	Numri i Skedave të punësimit të plotësuaratë	392	280	138	82	71	963
9	Numri i ish-studentëve të UBT të informuar dhe afruar pranë ALUMNI UBT	6	4	5	2	1	17
10	Numri i aktiviteteve trajnuese/leksione të hapura të organizuar në ambientet e njësisë kryesore	19					
11	Numri i praktikave mësimore në të cilat jeni përfshirë	6	4	4	3	3	20

12	Numri i seminareve, workshop, konferenca, apo organizim të pritjeve të vizitorëve të ndryshëm në njësine kryesore	5	4	2	3	2	16
13	Numri i studentëve pjesmarrës në studimet e realizuara nga QKA	44	27	47	11	5	134

Trajnime bazë të ZKS (QKA)

Zyrat e Karrierës organizojnë sesione trajnimi për studentët e pesë fakulteteve me fokus në zhvillimin e aftësive të buta (*soft skills*) të nevojshme për tregun e punës. Disa nga temat kryesore të trajnimeve janë:

- Shkrimi i CV-së
- Shkrimi i letër-motivimit
- Intervistat e punës: përgatitja dhe teknika të intervistimit
- Aftësitë e komunikimit dhe menaxhimit të karrierës
- Ndihma në orientimin profesional për studentët e diplomuar

Partneritete me Kompani dhe Organizata

Në periudhen e vitit akademik 2024-2025 janë krijuar marrëveshje me disa kompani si:

FMB	1	Gjelbërimi 2000 shpk Kamëz
	2	Agrokoni
	3	Agrotek
	4	Bio.inspekta
	5	Salvia Nord
	6	Austria praemix shpk
	7	Dua punë (dm consulting)
	8	ADAD Malore
	9	MBM Company
	10	Enofama
	11	Bio Bes
FEA	12	NOA sha
	13	Njoftime.com
	14	Deloitte Albania
	15	Zyre Kontabiliteti AKH
	16	Goethe_Zentrum
	17	Kredo Finance
	18	Raiffeisen Bank
	19	Interest Motivation Power
	20	AIIESEC
	21	Neptun
	22	Zyra e Punës

	23	SPAR
	24	Posta TNT Group
FSHP	25	Kajmaku
	26	Fidanishte SOTA
	27	Dru-Tech Sh.P.K
	28	Grid Studio Architect Interior/Exterior Design
	29	Home Atelier
FMV	30	Austrian Institute of Excellence
	31	Petville shpk
	32	Pets & Partners
	33	Vet Hospital
	34	Le Spot Group
	35	Firma Inka
	36	Pajisje Laboratorike
	37	Pulari Savio
	38	Royal Kanine
	39	Shoqata Shendritesve
FBU	40	Lufra
	41	Birra Stela
	42	Kantina "Miqesia"
	43	Hako
	44	Erzeni
	45	Natyrall
	46	<u>Zdrava</u>

Gjithashtu interest ka shprehur edhe Credins Bank për bashkëpunim. Këto biznese janë angazhuar dhe kane ofruar mbështetje lidhur me mundësi për kryerjen e praktikës profesionale për studentët. ZKS ka sherbyer si ure lidhese efikase dhe ndihmuese per grupet e interesit.

Pjesmarrja në aktivitete të ndryshme

Tabela 26. Qendra e Karrieres UBT ka qene pjesëmarrëse në disa aktivitete të organizuara nga aktorë të tjerë.

Nr.	Aktivitetet të Zhvilluara/Mbështetura nga Qendra e Karrierës	Koha e Aktiviteteve
1	Takim me RisiAlbania	Shtator 2025
2	Konferenca "Grow Smart - Confindustria	Korrik 2025
3	Trajnim nga BNJ - UBT	30 Qershor
4	Konferencë Përmbyllëse - RisiAlbania	Qershor 2025
5	Job Creation Through quality management in agribusiness - RisiAlbania	26 Qershor 2025
6	Takim me Grupin e Punës Boku - Vjenë për forcimin e komunikimit dhe promovimit	12 Qershor 2025

7	Panairi i Bujqësisë - Lushnjë	Maj 2025
8	Modelimi Bioekonomik në Shërbim të Politikëbërjes në Bujqësi” – Ligjëratë nga CIHEAM IAMM në UBT	Maj 2025
9	Sondazhi i Ascal me studentët	Maj 2025
10	Takim me Biznesin (Kracu)	Maj 2025
11	Takim me Biznesin (Megatek)	Prill 2025
12	Panairi Work & Study	Shkurt-Mars 2025
13	Panairi i Teknologjisë - Pallati i Kongreseve	Shkurt 2025
14	Aktivitetet sportive në bashkëpunim me FSHSU	Dhjetor 2024
15	Parada "Rrënjët Kuq e ZI"	Nëntor 2024
16	Ceremonia e Diplomimit	Nëntor 2024
17	Zhvillimi i Teknologjisë dhe Transferimi i Njohurive në Sektorin e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike në Shqipëri (BMA)	Nëntor 2024
18	Konferencë Kombëtare Tiranë, Shqipëri – RisiAlbania	14 Nëntor 2024
19	Rëndësia e këshillimit për studentë - bashkëpunimi me RisiAlbania	Tetor 2024

Organizimi Klubeve Studentore Sportive

Viti akademik 2024-2025 ka qënë vit i suksesshem për klubet studentore sportive. Sukseset konsistojnë në faktin se:

- Ekipi i basketbollit (meshkuj) vazhdon të jetë një nga ekipet pretendente në çdo aktivitet që zhvillohet përfshirë edhe Kampionatin Kombëtar Universitar ku marrin pjesë të gjithë universitetet në Shqipëri, (publike edhe private). Kampionati u zhvillua gjatë periudhës Nëntor 2024 – Mars 2025
- Viti akademik 2024-2025 është i dyti viti në historinë e Universiteti Bujqësor të Tiranës që merr pjesë në Kampionatin Kombëtar të Sportit Universitar me ekip Volejboli për femra. Është hera e dytë në gjithë historinë e UBT që ekipi i volejbollit për femra përfaqësohet në mënyrë dinjitoze. Objektivi në vijim është konsolidimi këtij ekipi dhe pasurimi tij me studente që dëshirojnë të behen pjesë e ekipit për lojë më cilësore
- Për të katërtin vit radhazi UBT u paraqit dhe mori pjesë në Kampionatin Kombëtar të Sportit Universitar, me ekipin e Futsallës. Kampionati u zhvillua në periudhën Nëntor 2024 – Mars 2025. Mes një konkurrence shumë të fortë, nga pjesëmarrja e gjithë universiteteve publike dhe private, ekipi ynë zuri vendin e katërt.

Vlen të theksojmë faktin se çdo vit kemi interesim në rritje nga studentët për tu përfshirë në aktivitetet sportive nën logon e UBT dhe për të marrë pjesë në Kampionatin Kombëtar të Sportit Universitar.


9.1 GJURMIMI I TË DIPLOMUARVE 2023-2024

Një nga funksionet e QKA, është të gjurmohet ecurinë e studentëve të UBT në tregun e punës, mbasi ata përfundojnë studimet dhe diplomohen. Proçesi i studimit ka kaluar në tre faza; së pari, është

përpiluar pyetësor¹, i cili përbehet nga tre seksione: profile i studentit, vlefshmëria e diplomës së UBT për tregun e punës, dhe punësimi i tyre. Kështu, ky pyetësor është zhvilluar përgjatë periudhës janar - qershor 2024, dhe çdo vit realizohet studimi për këtë qëllim. Targeti i studimit

Figura 17. Punësimi i të diplomuarve

janë studentët e UBT, tashme të diplomuar dhe i referohemi të diplomuarve në vitin akademik 2023-2024. Pyetësor është kryer për studentët e diplomuar në UBT gjatë **vitit akademik 2023-2024** ku



numri përgjithshëm i tyre ka qënë 1306 dhe në vlera numerike ka qënë: FEA me 649, FBU me 165, FSHP me 82, FMV me 71 dhe FBM me 339 studente.

Studentë të diplomuar sipas fakulteteve për vitin akademik 2023-2024.




Figura 18. Studente të diplomuar 2023-2024

9.2 TË DIPLOMUARIT TE FEA NË VITIN AKADEMIK 2023-2024 DHE PUNËSIMI TYRE.


Në total, të FEA në vitin akademik 2023-2024 janë diplomuar 649 studentë nga të cilët kemi arritur të kemi informacion vetëm për 392 studentë ndërsa 257 të diplomuar nuk kanë komunikuar më QKA në asnjë rrugë komunikimi. Nga 392 të diplomuar të cilët i janë përgjigjur pyetësorit ka rezultuar se: të punësuar në sektorin public janë 40, të punësuar në privat janë 221, të vet-punësuar

janë 5 dhe 126 janë ende të papunësuar në fushën për të cilën kanë studiuar. Si numër të përgjithshëm kemi 266 të punësuar.

9.3 TË DIPLOMUARIT TE FBM NË VITIN AKADEMIK 2023-2024 DHE PUNËSIMI TYRE.

Në vitin akademik 2023-2024 në FBM janë diplomuar 339 studentë, nga të cilët kemi: të punësuar në sektorin privat 23, në sektorin publik 3, të vet-punësuar 11 dhe të punësuar por jo në profesion janë 43. Nga pyetsori rezulton se 24 janë ende të papunësuar. Nga 339 studentë, 176 prej tyre nuk kanë kthyer përgjigje, ndërsa me 59 të diplomuar nuk kemi mundësi komunikimi.

Figura 19. Punesimi I te diplomuarve FBM



1. Të diplomuarit te FBU në vitin akademik 2023-2024 dhe punësimi tyre.




Figura 20. Punesimi I te diplomuarve FBU

Në vlera numerike, lidhur me punësimin e të diplomuarve për vitin akademik 2023-2024 në FBU, theksojmë se janë diplomuar 165 studentë nga të cilët 74 nuk kanë kthyer përgjigje. Nga pyetsoret

kemi: 20 ende nuk kanë filluar punë ndërkohë që 71 janë punësuar përkatësisht 18 në sektorin publik, 49 në sektorin privat dhe 4 janë të vetë-punësuar.

9.4 TË DIPLOMUARIT TE FSHP NË VITIN AKADEMIK 2023-2024 DHE PUNËSIMI




Figura 21. Punesimi I te diplomuarve FSHP

Në FSHP, në vitin 2024 janë diplomuar 82 studentenga të cilët 17 nuk i janë përgjigjur pyetsorit. Theksojmë se nga 82 te diplomuar, 65 janë të punësuar që vitin e pare, 8 në sektorin publik dhe 57 në sektorin privat, prej të cilit 8 janë vetë-punësuar.

9.5 TË DIPLOMUARIT TE FMV NË VITIN AKADEMIK 2023-2024 DHE PUNËSIMI TYRE.




Figura 22. Punesimi I te diplomuarve FMV

Në FMV, për vitin akademik 2023-2024 janë diplomuar 71 studentë prej të cilëve kemi 37 të punësuar, 14 të papunësuar dhe 20 të padeklaruar. Nga 37 të punësuar kemi shpërndarjen si vijon: sektori public 7, sektori privat 26 dhe 4 të vet-punësuar.

9.6 TË DIPLOMUARIT E VITIT AKADEMIK 2023-2024 NË UBT.




Figura 23 Studentet diplomuar UBT

Në vlera numerike, lidhur me studentët e diplomuar në vitin akademik 2023-2024 theksojmë se nga 1306 studentë të diplomuar kemi marrë përgjigje prej tyre vetëm nga 1204. Referuar aspektit të punësimit por dhe jo vetëm, kemi të punësuar në sektorin publik 76 të diplomuar, në sektorin privat 368, të vet-punësuar 32, të papunësuar 184 dhe që nuk janë deklaruar janë 544 të diplomuar. Në fund, eidentojmë faktin se 102 studentë të diplomuar kanë humbur mundësinë e komunikimit/kontaktet me stafin e QKA.